

468 m

DRAFT

**VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I
PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË
MAMUSHËS 2026 - 2034**

R-205



Rru

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	8
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	10
2.1. DIREKTIVA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR E BASHKIMIT EVROPIAN	10
2.2. PROCEDURA E VSM-së.....	10
2.3. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së	10
2.4. STRATEGJIA 2020 E BE-së	11
2.5. OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË MIJËVJEÇARIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA	11
2.6. KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT	12
2.6.1. KONVENTA ÅRHUS	12
2.6.2. KONVENTA ESPOO.....	12
2.6.3. PROTOKOLLI I KIEVIT	12
2.7. HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE	13
2.7.1. LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR	13
2.7.2. LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR	14
2.8. PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME.....	14
3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM-së.....	15
3.1. OBJEKTIVAT:.....	15
3.2. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së.....	16
4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE.....	18
4.1. POZITA DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE.....	18
4.2. VEÇORITË MJEDISORE	18
4.2.1. PEDOLOGJIA – PËRMBAJTJA E DHERAVE.....	18
4.2.2. GJEOLOGJIA DHE TOKAT.....	19
4.2.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE	20
4.2.4. NDJESHMËRIA E UJËRAVE NËNTOKËSORE.....	21
4.2.5. LARTËSIA MBIDETARE.....	22
4.2.6. KUSHTET KLIMATIKE	23
4.2.7. PYLLTARIA.....	23
4.2.8. INFRASTRUKTURA TEKNIKE	24
4.2.9. FAKTORËT MJEDISOR DHE NIVELET E NDOTJES	24
4.2.10. SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI	26

5. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE.....	27
5.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE	27
5.2. ZONAT NË RREZIK TË DEGRADIMIT TË THELLË MJEDISOR	27
5.3. ZONAT ME NDJESHMËRI TË VEÇANTË MJEDISORE.....	27
6. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PZHk-së	29
6.1. DEKLARATA E VIZIONIT PËR KOMUNËN	29
6.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHk SIPAS FUSHAVE TEMATIKE.....	29
6.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK	29
6.2.2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE	30
6.2.3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI.....	31
6.2.4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	32
6.2.5. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI.....	33
6.2.6. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE.....	34
6.2.7. VENDBANIMET	34
6.2.8. VENDBANIMET JO FORMALE.....	35
6.2.9. BANIMI	35
6.2.10. SHFRYTËZIMI I TOKËS	36
6.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR	37
6.3.1. ASPEKTE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE.....	38
6.3.2. POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK	38
6.3.3. VEÇORITË NATYRORE KRYESORE TË KOMUNËS DHE ZONAT QË NDIKOHEN	39
6.3.4. ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS	40
6.3.5. ÇËSHTJE MJEDISORE QË LIDHEN ME MJEDISIN FIZIK	41
6.3.6. MJEDISI I NDËRTUAR DHE KULTURA	42
7. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE	44
7.1. OBJEKTIVAT E VSM.....	44
7.2. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL	45
7.3. QËLLIMET STRATEGJIKE	47
7.4. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT, CILËSIA, OFRIMI I SHËRMBIMEVE, DHE EFIÇENCA E ENERGJISË.....	49
8. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE	51
8.1. METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SHKALLËS SË NDIKIMEVE	51
8.2. PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT	52
9. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	58

9.1.	KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, ZHVILLIMI KOMPAKT	58
9.2.	NDRYSHIMET NË KLIMË	58
9.3.	CILËSIA E AJRIT	58
9.4.	PËRFITIMET NGA HAPËSIRAT E GJELBRA URBANE	59
9.5.	ENERGJIA E RINOVUESHME	59
9.6.	MBROJTJA E TOKËS	59
9.7.	MBROJTJA E RESURSEVE UJORE	60
9.8.	REDUKTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE	61
9.9.	MENAXHIMI I MBETURINAVE	61
10.	PLANI I MONITORIMIT	63
11.	PËRFUNDIME	65
12.	LITERATURA	67

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës	17
Tabela 2 Ajri, sipas ndotësve përkatës dhe lokacioneve matëse, 2021-2024.....	25
Tabela 3 Komponentët mjedisor të parapara në raportin e VSM.....	51
Tabela 4 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisore	54
Tabela 5 Tabela e përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit në funksion të OM	55
Tabela 6 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së	57
Tabela 7 Plani i Monitorimit Mjedisor	64

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Përbërja pedologjike e tokës	18
Figura 2 Përbërja gjeologjike	19
Figura 3 Rrjeti hidrografik.....	20
Figura 4 Ndjeshmëria e ujërave nëntokësore.....	21
Figura 5 Hipsometria e terrenit	22
Figura 6 Ekspozicioni i terrenit	23

LISTA E SHKURTIMEVE

- **MMPHI** – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- **AMMK** – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
- **BE** - Bashkimi Evropian
- **KK** - Kuvendi Komunal
- **GIS** – Sistemi i Informacionit Gjeografik
- **GNP** - Grimcat e Ngurta Pezull
- **NOQ** - Ndotësit Organik të Qëndrueshëm
- **OBSH** - Organizata Botërore e Shëndetësisë
- **OJQ** - Organizata Jo Qeveritare
- **VBJ** – Vendbanime Jo Formale
- **OZHM** - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
- **PZHK** - Plani Zhvillimor Komunal
- **HZK** - Harta Zonale Komunale
- **PRRH** – Plani Rregullues i Hollësishëm
- **TeR** - Termat e Referencës
- **UNDP** - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
- **UNEP** - Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
- **VNM** - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
- **VSM** - Vlerësim Strategjik Mjedisor
- **ZVM** - Zona e Veçanta e Mbrojtura
- **UNMIK** - Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
- **CO** – Monoksidi i Karbonit

- **EC** – Komisioni Evropian
- **IPPC** – Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
- **KB** – Kombet e Bashkuara
- **MCS** – Mercalli-Cancani-Sieberg
- **NO₂** – Dioksidi i Azotit
- **O₃** – Ozoni
- **SO₂** – Dioksidi i Squfurit
- **PM_{2.5}** – Grimcat e Suspenduara $\leq 2.5\mu\text{m}$
- **PM₁₀** – Grimcat e Suspenduara $\leq 10\mu\text{m}$
- **OKB** – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- **OM** – Objektivat Mjedisore
- **OZHM** – Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit
- **OZHQ** – Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
- **SDG** – Sustainable Development Goals

1. HYRJE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për politika, plane dhe programe vlerëson pasojat qysh në fazat e hershme të vendimmarrjes. Gjithashtu VSM është një proces që synon integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Koncepti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor vjen nga politikat dhe programet e niveleve më të larta të planifikimit dhe shfrytëzimit të tokës të cilat kanë synime strategjike dhe vizionare dhe për të cilat kërkohet VSM sipas ligjit.

Qëllimi i raportit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si dhe të ofrojë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën 2001/42/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, dhe ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili është transpozim i Direktivës 2001/42/EC të Bashkimit Evropian dhe përcakton kushtet, procedurat dhe mënyrën e vlerësimit strategjik të mjedisit për të siguruar mbrojtjen e tij dhe shëndetit të njeriut.

Vlerësimi i strukturuar mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës do të organizohet si vijon:

- Përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor; përshkrimin e vizionit, prioriteteve dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Mamushës dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrimin e aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimet e pritura në rast të mos zbatimit të planit;
- Përshkrimin e karakteristikave mjedisore të zonave që kanë të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrimin e problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrimin e objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrimin e ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
- Efektet kumulative të komponentëve mjedisore;
- Përshkrimin e masave që parashikohen për parandalimin, reduktimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit;
- Përmbledhje e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit;
- Përshkrimin e planit të monitorimit dhe raportimit.

Të dhënat dhe informacionet për komunën e Mamushës janë siguruar nga Komuna dhe drejtoritë përkatëse, nga hulumtime të ndryshme të kryera për këtë komunë, nga Plani Zhvillimor Komunal i vjetër dhe hulumtime tjera nga interneti.

Megjithëse për këtë komunë ekziston një Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) i hartuar për dokumentin e mëparshëm të Planit Zhvillimor Komunal, ky raport përgatitet në funksion të dokumentit të ri planifikues dhe adreson ndryshimet, zhvillimet dhe kërkesat aktuale ligjore e mjedisore. Si i tillë, ai synon të sigurojë që zhvillimet e ardhshme të jenë në përputhje me legjislacionin vendor për mjedisin, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare përkatëse.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1. DIREKTIVA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR E BASHKIMIT EVROPIAN

Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, u aprovua më 27 Qershor 2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe programeve publike të cilat janë subjekt i përgatitjes dhe/ose miratimit nga një autoritet në nivelin kombëtar, rajonal ose lokal, ose që përgatiten nga një autoritet për miratim përmes procedurave legjislative dhe të cilat kërkohen nga dispozitat legjislative, rregullatore ose administrative.¹

Sipas Direktivës 2001/42/EC, Vlerësimi Strategjik Mjedisor është i detyrueshëm për planet dhe programet që:

- Përgatiten për sektorë si bujqësia, pylltaria, peshkimi, energjetika, industria, transporti, menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave, telekomunikimi, turizmi, planifikimi urban dhe rural ose shfrytëzimi i tokës, dhe që vendosin kornizën për miratimin e projekteve të ardhshme të listuara në Direktivën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM);
- Kërkojnë vlerësim sipas Direktivës për Vendbanimet (Habitats Directive).

Për planet dhe programet që nuk përfshihen drejtpërdrejt në këto kategori, shtetet anëtare janë të obliguara të zbatojnë procedurën e shqyrtimit (screening), me qëllim të përcaktimit nëse ato mund të kenë ndikime të rëndësishme mjedisore. Në rast se konstatohet një ndikim i tillë, realizimi i VSM-së bëhet i domosdoshëm. Kjo procedurë bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

2.2. PROCEDURA E VSM-së

Raporti i VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Me aprovimin e planit apo programit, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni, si dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme jo të favorshme në fazat e hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

2.3. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën e VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën e VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001L0042>

2.4. STRATEGJIA 2020 E BE-së

Përveç dokumenteve legjislativ të BE-së të përmendura më sipër, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha, është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor, duke qenë se bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet strategjike përfshijnë “zhvillimin e shpejtë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha si: “Evropa efikase sa ju përket burimeve” dhe “Një politikë industriale për epokën e globalizimit” të lidhura drejtpërdrejtë me çështjet e qëndrueshmërisë. Nisma të tjera si “Agjenda Digjitale për Evropën”, “Unioni i Përtëritjeve”, “Rinia në lëvizje”, “Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune” dhe “Platforma evropiane kundër varfërisë”, gjithashtu kanë një kontribut në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm nëse do të zbatoheshin në mënyrë efikase.

Strategjia gjithashtu përfshin objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë, siç janë:

- Zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave serrë;
- 20% rritje të shkallës së energjisë nga burime të ripërtëritshme efikase të energjisë.

Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

2.5. OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË MIJËVJEÇARIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Kombet e Bashkuara kanë një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës. Edhe pse jo shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për të siguruar kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në New York për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, ku pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit².

Nga shtatë (7) objektivat e kësaj nisme, një nga to i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programeve të vendit dhe kthimi mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm të sigurt dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetë e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit është bërë progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi agjendën e zhvillimit të pas-2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Agjenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë (17) Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e kanë arritur. Në këtë agjendë të re të zhvillimit, komponenta e mjedisit konsiderohet të ketë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa çështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale duke afektuar të gjitha aktivitetet njerëzore dhe cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posaçme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva të tjera të cilat në thelb përmbajnë aspekte mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

2.6. KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT

2.6.1. KONVENTA ÅRHUS

Konventa e Aarhus-it (25 Qershor 1998), sipas të cilës shteti duhet të garantojë të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe t'i drejtohet trupave gjykues në lidhje me çështjet e mjedisit.

Tri shtyllat kryesore të konventës:

- E drejta e publikut për informacion;
- E drejta e publikut për pjesëmarrje;
- E drejta e publikut për drejtësi.

2.6.2. KONVENTA ESPOO

Konventa Espoo përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Po ashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.

2.6.3. PROTOKOLLI I KIEVIT

Protokolli i Kievit kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikimin, turizmin, planifikimin e qytetit ose të fshatit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Protokolli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes duke zhvilluar politika të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve.

Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkon nga palët e tij që të vlerësojnë pasojat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokolli i Kievit ofron një pjesëmarrje të gjerë të publikut në vendimmarrjen e qeverisë në sektorët zhvillimorë. Protokolli i Kievit rëndësi të veçantë i kushton edhe shëndetit njerëzor.

2.7. HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE

2.7.1. LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR

Ligji nr. 03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, ka për qëllim që përmes vlerësimit strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ligji nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve përkatëse me ndikim domethënës në mjedis, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji përcakton kriteret për përcaktimin e nevojës për VSM, të dhëna mbi përgatitjen e raportit, informacionet që duhet përfshirë, debati publik, etj. Planet dhe programet të cilat duhet t'i nënshtrohen procesit të VSM, nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin e VSM. Ligji është përafuar me Direktivën 2001/42/EC, datë 27 Qershor 2001.³ Përveç, Ligjit Nr. 03/L-230 të Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë konsultuar edhe ligjet tjera relevante mjedisore dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti:

- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligji nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor;
- Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-233 mbi Mbrojtjen e Natyrës;
- Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, shfuqizuar pjesërisht nga Ligji nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës;
- Ligji nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
- Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma;
- Ligji nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, ndryshuar/plotësuar nga Ligji nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina;
- Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate;
- Ligji nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për Kimikate;
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike;
- Ligji nr.08/L-137 për Pyjet;
- Ligji nr. 02/L-53 për Gjuetinë;
- Ligji nr. 08/L-084 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë;
- Ligji nr. 08/L-074 për Turizmin;
- Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2711>

- Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet;
- Ligji nr. 08/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158;
- Ligji 08/L-275 për Rrugët;
- Ligji 08/L-250 për Ndryshime Klimatike;
- Ligji 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale;
- Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, etj.

2.7.2. LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji Nr. 03/L-106), ndërkaq në Korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet;
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrjen e palëve të interesuara. PZHK, si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai përfshin periudhën minimale 8 vjeçare dhe planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale brenda komunës. Të gjitha nivelet e planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin plan obligohet përgatitja e raportit të VSM paralelisht me planin.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikat e zhvillimit hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin e zhvillimeve urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmoni me politikat dhe programet nacionale si dhe duke respektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

2.8. PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME

Përveç legjislacionit, raporti i VSM-së duhet të marrë parasysh edhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për Mjedisin dhe Planin e Veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM-së

Qëllimi i hartimit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore.

3.1. OBJEKTIVAT:

- Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit
- Të konsiderojë efektet e planit mbi mjedisin;
- Të identifikojë alternativat më të përshtatshme për mjedisin;
- Të identifikojë dhe parandalojë efektet kumulative;
- Të rrisë performancën e VNM;
- Të identifikojë dhe orientojë procesin lidhur me efektet potenciale negative mbi mjedisin;
- Të ofrojë argumente për justifikimin e projekteve të propozuara;
- Të reduktojë kohën për grumbullimin e informacionit apo për studime paraprake;
- Të integrojë çështjet mjedisore në procesin e vendimmarrjes;
- Të promovojë mbrojtjen e mjedisit;
- Të kontribuojë për një vendimmarrje sa më të mirë;
- Të ndihmojë për një vendimmarrje transparente, përballë interesave të publikut dhe grupeve të interesit.

3.2. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut, të shkaktuara nga zbatimi i planit, programit ose dokumenteve tjera strategjike. Në raportin e VSM përfshihen edhe masat e rekomanduara për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e planit. Për të siguruar efektivitetin e procesit të VSM, është thelbësore që dokumentet strategjike të marrin në konsideratë disa opsione alternative për arritjen e qëllimeve të identifikuara. Në këtë rast VSM lejon vendimmarrësit të marrin në konsideratë opsionin më miqësor ndaj mjedisit.

Fazat kryesore të procesit të VSM me bazë mbi praktikatat ndërkombëtare:

SCREENING

- Plani/programi subjekt i VSM

SCOPING

- Çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM

DOKUMENTAT/RAPORTI

- Përgatitja e raportit të VSM dhe Projekt Planit/Programit

KONSULTIMI

- Konsultimi me grupet e interesit dhe me publikun

VENDIMMARRJA

- Lëshimi i vendimit për planin/programin përfundimtar bazuar në inputet nga hapi i konsultimit

MONITORIMI

- Monitorimi i efekteve mjedisore të planit përfundimtar

Nevojshmëria	Përshkrimi
Përfshirja/qëllimit të VSM-së	Identifikimi i çështjeve që do të përfshihen në studimin e VSM-së do të orientojë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale në zonë dhe konservimin e të gjitha asetëve më rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese përbën bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemes së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme të konsiderohen tendencat e mundshme të zhvillimit. Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi më të mirë të çështjeve kyçe, dhe një identifikimi më të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. VSM mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të planit, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve ose planeve të tjera në afërsi të zonës. VSM do të analizojë specifikisht masat adekuatë përmirësuese që do të rezultojnë nga plani. Duke konsideruar, bashkërisht, ndikimet dhe raportin benefit/cost të veprimit ose mos veprimit do të analizohen opsionet dhe përzgjidhet ai që rezulton më i miri në planin ekonomik dhe mjedisor.
Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit.
Adoptimi	Jepet informacion mbi përputhshmërinë e objektivave mjedisor me elementët kyçe të planit, të identifikuar paraprakisht. Mos përputhshmëria e objektivave mjedisor me planin nevojitet të rishikohen dhe propozohen ndryshime të mundshme në plan.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisor dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar në këtë studim.

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës

4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

4.1. POZITA DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE

Komuna e Mamushës shtrihet në Rrafshin e Dukagjinit, në pjesën juglindore të Kosovës, dhe karakterizohet nga terren kryesisht i rrafshët me toka bujqësore pjellore. Territori përfshin gjithashtu disa zona kodrinore në veriperëndim dhe juglindje, të mbuluara me vreshta, shkurre dhe vegjetacion pyjor.

Komuna ka një sipërfaqe prej 10.94 km², duke qenë njëra nga komunat më të vogla në Kosovë. Lartësia mbidetare varion nga 320 deri në 360 m, ndërsa pika më e lartë arrin 460 m. Nëpër territorin e saj rrjedhin lumenjtë Toplluha dhe Tërrnja, të cilët përshkojnë kryesisht zonat bujqësore.

Mamusha kufizohet me komunat e Prizrenit, Suharekës dhe Rahovecit. Vendbanimi i vetëm është qendra urbane e Mamushës, e cila ka pozitë të favorshme në raport me rrjetin rrugor rajonal dhe qendrat përreth.

4.2. VEÇORITË MJEDISORE

4.2.1. PEDOLOGJIA – PËRMBAJTJA E DHERAVE

Territori i Komunës së Mamushës karakterizohet nga prania e tokave aluviale dhe smonicave, të cilat përbëjnë bazën kryesore të fondit tokësor.

Tokat aluviale shtrihen kryesisht në zonat fushore dhe përgjatë rrjedhave ujore, duke u dalluar për pjellori të lartë dhe kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë. Smonicat dominojnë në pjesët veriore dhe veri-perëndimore të territorit dhe karakterizohen nga përmbajtje më e lartë argjile dhe kapacitet i mirë për mbajtjen e ujit. Në zona të caktuara evidentohen procese të degradimit dhe erozionit të tokës, të cilat kërkojnë masa të përshtatshme për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve tokësore.




Figura 1 Përbërja pedologjike e tokës

4.2.2. GJEOLGJIA DHE TOKAT

Ndërtimi gjeologjik i territorit të Komunës së Mamushës dominohet nga depozitimet sedimentare të periudhave të reja gjeologjike, të lidhura kryesisht me aktivitetin e rrjedhave ujore dhe zhvillimin e Rrafshit të Dukagjinit. Formacionet kryesore përbëhen nga aluvione, sedimente lumore dhe depozitime proluviale.

Këto depozitime kanë krijuar kushte të favorshme për formimin e tokave bujqësore dhe paraqesin bazën kryesore të karakteristikave gjeologjike të territorit. Në disa pjesë të komunës paraqiten edhe depozitime të përziera me rërë, zhavorr dhe argjilë, që pasqyrojnë proceset sedimentare të zhvilluara në këtë zonë.




Figura 2 Përbërja gjeologjike

4.2.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE

Hidrografia e Komunës së Mamushës përbëhet kryesisht nga lumenjtë Toplluhë dhe Tërrn, të cilët përshkojnë territorin nëpër zona fushore dhe toka bujqësore. Këto rrjedha ujore ndikojnë në karakteristikat natyrore të territorit dhe në aktivitetet bujqësore të komunës.

Cilësia e ujit në këta lumenj është e kufizuar për përdorim si ujë i pijshëm, ndërsa furnizimi me ujë për popullsinë dhe aktivitetet ekonomike mbështetet kryesisht në burimet ujore nëntokësore, të cilat përbëjnë resurset kryesore ujore të komunës.




Figura 3 Rrjeti hidrografik

4.2.4. NDJESHMËRIA E UJËRAVE NËNTOKËSORE

Territori i Komunës së Mamushës karakterizohet kryesisht nga një shkallë e lartë e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësore ndaj ndotjes, veçanërisht në zonat qendrore, jugore dhe lindore të komunës. Kjo lidhet me kushtet gjeologjike dhe pedologjike që favorizojnë infiltrimin e ujit dhe të ndotësve drejt akuiferëve.

Zona me ndjeshmëri më të ulët paraqiten në pjesët veriore dhe veriperëndimore të territorit, ku kushtet natyrore ofrojnë mbrojtje më të madhe të ujërave nëntokësore. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre burimeve për furnizimin me ujë, planifikimi hapësinor dhe aktivitetet zhvillimore duhet të parashohin masa për mbrojtjen e tyre nga ndotja, veçanërisht nga ujërat e zeza, aktivitetet bujqësore dhe menaxhimi i mbeturinave.




Figura 4 Ndjeshmëria e ujërave nëntokësore

4.2.5. LARTËSIA MBIDETARE

Territori karakterizohet nga relief kryesisht i rrafshët, tipik për Rrafshin e Dukagjinit, me lartësi mbidetare që varion kryesisht ndërmjet 320 dhe 360 m. Këto karakteristika krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe vendbanimeve.

Zona të veçanta kodrinore paraqiten në pjesën veriperëndimore dhe juglindore të komunës, ndërsa pika më e lartë e territorit arrin rreth 460 m mbi nivelin e detit. Këto zona karakterizohen nga pjerrësi më të theksuara dhe mbulesë më të zhvilluar bimore krahasuar me pjesën qendrore fushore.




Figura 5 Hipsometria e terrenit

4.2.6. KUSHTET KLIMATIKE

Komuna e Mamushës karakterizohet nga klimë kontinentale me ndikime mesdhetare, e cila krijon kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera ekonomike. Klima karakterizohet nga vera të ngrrohta dhe dimra relativisht të butë, me reshje të shpërndara gjatë vitit.

Kushtet klimatike kontribuojnë në pjellorinë e tokës dhe mundësojnë kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Megjithatë, periudhat e thata gjatë sezonit veror kërkojnë menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të territorit.




Figura 6 Ekspozicioni i terrenit

4.2.7. PYLLTARIA

Territori i komunës përfshin rreth 137 ha sipërfaqe pyjore, të përbëra kryesisht nga lloje drunore si ahu, qarri, bungu dhe shkoza. Pyjet kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës nga erozioni, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik.

Sipërfaqet pyjore i përkasin kryesisht brezit kodrinor-malor dhe përfaqësojnë habitate me vlera ekologjike për florën dhe faunën lokale. Megjithatë, aktivitetet e pakontrolluara në të kaluarën kanë ndikuar në degradimin e pjesëve të caktuara të pyjeve.

Për ruajtjen e funksioneve ekologjike dhe mbrojtëse të pyjeve, nevojitet menaxhim i qëndrueshëm, parandalim i degradimit dhe promovim i aktiviteteve të pyllëzimit në zonat e përshtatshme.

4.2.8. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Furnizimi me ujë mbështetet kryesisht në burimet ujore nëntokësore dhe rrjetin ekzistues të ujësjellësit, ndërsa sistemi i kanalizimit nuk mbulon të gjithë territorin e komunës. Po ashtu, ujërat e zeza shkarkohen pa trajtim paraprak, duke paraqitur presion potencial mbi mjedisin dhe burimet ujore. Menaxhimi i ujërave atmosferike realizohet kryesisht përmes sistemit të kombinuar të kanalizimit, me disa segmente më të reja të pajisura me sisteme të veçanta drenazhimi.

Furnizimi me energji elektrike realizohet përmes rrjetit rajonal të transmetimit dhe shpërndarjes, ndërsa ngrohja e objekteve mbështetet pothuajse tërësisht në sisteme individuale. Burimi kryesor i energjisë për ngrohje mbetet druri, gjë që ndikon në cilësinë e ajrit dhe rrit presionin mbi resurset natyrore.

Nga aspekti mjedisor, menaxhimi i mbeturinave paraqet një nga sfidat kryesore të komunës. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave nuk mbulon të gjitha amvisëritë, ndërsa mbeturinat e grumbulluara transportohen në deponinë rajonale të Landovicës. Mbulimi i pjesshëm me shërbim ka ndikuar në paraqitjen e deponive ilegale, të cilat përbëjnë burim potencial të ndotjes së tokës, ujërave dhe peizazhit. Gjithashtu, nuk raportohen aktivitete të organizuara të ndarjes në burim apo riciklimit të mbeturinave, ndërsa mbeturinat menaxhohen kryesisht si mbeturina të përziera. Për këtë arsye, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave, zgjerimi i mbulimit me shërbim dhe eliminimi i deponive ilegale mbeten ndër prioritetet kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

4.2.9. FAKTORËT MJEDISOR DHE NIVELET E NDOTJES

Gjendja mjedisore karakterizohet nga një sërë presionesh që ndikojnë në cilësinë e tokës, ujërave, ajrit dhe biodiversitetit. Burimet kryesore të ndotjes lidhen me menaxhimin jo të plotë të mbeturinave, shkarkimin e ujërave të zeza pa trajtim, përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi, si dhe me emetimet nga sektori i transportit dhe ngrohjes.

Problemet kryesore mjedisore përfshijnë trajtimin jo adekuat të ujërave të zeza, shkarkimin e tyre në rrjedhat ujore, praninë e deponive ilegale, mbulimin jo të plotë me shërbim të grumbullimit të mbeturinave, degradimin e sipërfaqeve pyjore, humbjen e tokës bujqësore si rezultat i ndërtimeve dhe proceset e erozionit në zona të caktuara. Gjithashtu, vërshimet periodike të lumit Toplluhë paraqesin rrezik për degradimin e tokës dhe habitatet natyrore përgjatë shtratit të lumit.

CILËSIA E AJRIT

Komuna e Mamushës nuk disponon stacion monitorimi për cilësinë e ajrit, prandaj vlerësimi i gjendjes bazohet në të dhënat e stacionit më të afërt monitorues në Prizren. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë ngrohja individuale e amvisërive, kryesisht me dru dhe në raste më të kufizuara me qymyr, si dhe emetimet nga trafiku rrugor.

Të dhënat e monitorimit për periudhën 2021–2024 tregojnë se koncentrimet mesatare të PM₁₀, PM_{2.5}, NO₂, SO₂, CO dhe O₃ kanë mbetur nën vlerat kufitare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta për ngrohje vazhdon të paraqesë burim potencial të ndotjes së ajrit, veçanërisht gjatë sezonit dimëror.

Substancat ndotëse, Lokacioni matës (µg/m3)	Viti			
	2021	2022	2023	2024
PM ₁₀ , Prizren	22.6	19.6	16.4	13.1
PM _{2.5} , Prizren	16.1	14.1	11.3	9.1
NO ₂ , Prizren	19.1	17.1	15.1	17.5
SO ₂ , Prizren	6.6	9.6	5.2	7
O ₃ , Prizren	60.3	59.2	56.1	54.5
CO, Prizren	0.5	0.6	0.6	0.7

Tabela 2 Ajri, sipas ndotësve përkatës dhe lokacioneve matëse, 2021-2024

NDOTJA E UJËRAVE

Burimet kryesore të ndotjes së ujërave në Komunën e Mamushës janë mbeturinat e ngurta, ujërat e zeza, pesticidet dhe plehrat artificiale. Hedhja e mbeturinave në vende të hapura dhe në rrjedhat ujore ndikon në uljen e cilësisë së ujit dhe degradimin e peizazhit natyror. Gjithashtu, derdhja e ujërave të zeza pa trajtim paraprak paraqet një nga burimet kryesore të ndotjes së lumenjve. Përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi mund të ndikojë në rritjen e ngarkesës me nitrate dhe substanca të tjera kimike në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Një pjesë e popullsisë shfrytëzon ujin nga puset për nevoja bujqësore, ndërsa mungojnë të dhëna të mjaftueshme mbi cilësinë e këtyre ujërave.

Aktualisht nuk ka të dhëna të plota për cilësinë e ujërave brenda territorit të komunës, çka e kufizon vlerësimin e saktë të nivelit të ndotjes. Megjithatë, bazuar në burimet ekzistuese të ndotjes, mund të vlerësohet se ujërat e zeza të patrajtuara dhe aktivitetet bujqësore paraqesin presionin kryesor mbi cilësinë e ujërave.

NDOTJA E TOKËS

Burimet kryesore të ndotjes së tokës lidhen me deponimin e pakontrolluar të mbeturinave dhe përdorimin e pesticideve dhe plehrave artificiale në bujqësi. Hedhja e mbeturinave në vende të hapura dhe në afërsi të rrjedhave ujore kontribuon në degradimin e tokës dhe në uljen e cilësisë së saj. Përdorimi i inputeve bujqësore, veçanërisht pesticideve dhe plehrave kimike, paraqet burim potencial të ndotjes së tokës dhe mund të ndikojë në cilësinë e saj në afat të gjatë. Gjithashtu, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe humbja e sipërfaqeve bujqësore paraqesin presione shtesë mbi këtë resurs natyror.

Aktualisht mungojnë të dhëna dhe monitorim i vazhdueshëm që do të mundësonin vlerësimin e shkallës së ndotjes së tokës nga ndotësit prioritarë, pesticidet, metalet e rënda apo ndotës të tjerë potencialë. Kjo e vështirëson vlerësimin e gjendjes aktuale të tokës në territorin e komunës.

NDOTJA AKUSTIKE

Trafiku, industria dhe mekanizmat bujqësor cilësohen si burime emetimit të niveleve të papranueshme të zhurmës. Mullinjtë e grurit dhe kompanitë e prodhimit të blloqeve dhe tubave në qytet janë pranë zonave të banuara dhe zhurma e shkaktuar nga këto fabrika sjell ndikim të madh në mjedis dhe në shëndetin e banorëve. Megjithatë në mungesë të sistemeve matëse është shumë e vështirë të bëhet një vlerësim me bazë në të dhëna ekzistuese nga burime potenciale të emetimit të zhurmave.

4.2.10. SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

RRËSHQITJET DHE EROZIONI

Bazuar në hartën e ndjeshmërisë së tokës ndaj erozionit, territori i Komunës së Mamushës dominohet nga kategori me ndjeshmëri të ulët dhe mesatare. Zonat me rrezik më të lartë janë të lokalizuara kryesisht në pjesët perëndimore dhe periferike të territorit komunal, ku kërkohet menaxhim i kujdesshëm i përdorimit të tokës dhe zbatim i masave mbrojtëse për parandalimin e degradimit të saj.

TËRMETET

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, Komuna e Mamushës bën pjesë në zonën sizmike të kategorisë VII MCS. Kjo e vendos territorin në një zonë me rrezik sizmik të moderuar, i cili duhet të merret parasysh gjatë planifikimit hapësinor dhe projektimit të infrastrukturës.

VËRSHIMET

Vërshimet paraqesin një nga rreziqet natyrore më të rëndësishme në territorin e Komunës së Mamushës. Zonat më të ekspozuara janë përgjatë lumit Toplluhë dhe rrjedhave të tjera lokale, ku përmytjet ndikojnë në tokat bujqësore dhe zonat e banuara. Faktorët kryesorë që ndikojnë në paraqitjen e vërshimeve janë reshjet intensive, kushtet hidrologjike të lumenjve, grumbullimi i mbeturinave dhe mosrregullimi i plotë i shtretërve të lumenjve. Për këtë arsye, masat për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjen nga vërshimet paraqesin prioritet për komunën.

ZJARRET

Komuna e Mamushës karakterizohet nga rrezik relativisht i ulët ndaj zjarreve pyjore për shkak të sipërfaqeve të kufizuara pyjore. Rastet e evidentuara lidhen kryesisht me zjarret në sipërfaqe bujqësore dhe incidente të izoluara në objekte gjatë periudhave me temperatura të larta.

5. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundësitë për përmirësim.

5.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE

Ky seksion përfshin një përmbledhje të:

- Zonave që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonave me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilat mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

5.2. ZONAT NË RREZIK TË DEGRADIMIT TË THELLË MJEDISOR

Në territorin e Komunës së Mamushës nuk identifikohen zona të degraduara në shkallë të gjerë apo “hotspot-e” mjedisore të nivelit industrial. Megjithatë, ekzistojnë disa zona dhe elemente mjedisore që janë të ekspozuara ndaj presioneve të vazhdueshme që lidhen kryesisht me hapësirat e ekspozuara ndaj ndotjes nga mbeturinat, ujërat e zeza dhe aktivitetet bujqësore. Në këtë kategori përfshihen zonat përgjatë lumit Toplluhë dhe rrjedhave të tjera ujore, të cilat ndikohen nga shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim, hedhja e mbeturinave dhe transporti i ndotësve nga sipërfaqet bujqësore. Po ashtu, zonat ku evidentohen deponi ilegale dhe grumbullim i pakontrolluar i mbeturinave paraqesin sipërfaqe me potencial të lartë degradimi të tokës, ujërave dhe peizazhit.

Sipërfaqet bujqësore të ekspozuara ndaj përdorimit intensiv të pesticideve dhe plehrave kimike, si dhe zonat ku vërehet presion nga zgjerimi i ndërtimit në tokë bujqësore, paraqesin gjithashtu zona me rrezik të degradimit të resurseve tokësore.

Nga aspekti i proceseve natyrore, zonat përgjatë lumit Toplluhë që preken nga vërshimet periodike dhe pjesët me ndjeshmëri mesatare ndaj erozionit paraqesin sipërfaqe me potencial degradimi të tokës dhe habitateve natyrore.

5.3. ZONAT ME NDJESHMËRI TË VEÇANTË MJEDISORE

Lumi Toplluha dhe rrjedhat e tjera ujore në territorin e komunës janë zona me ndjeshmëri të veçantë mjedisore. Këto ekosisteme ujore janë të ekspozuara ndaj shkarkimit të ujërave të zeza pa trajtim, hedhjes së mbeturinave dhe ndikimeve nga aktivitetet bujqësore. Nivelet e larta të ndotësve kimikë, siç janë fenolet, nitratet, dhe materiet e tjera ndotëse, shkaktojnë presion të madh në këto ekosisteme, duke rrezikuar shëndetin e tyre dhe aftësinë për të mbështetur jetën e shtazëve dhe bimëve.

Tokat bujqësore me bonitet të lartë përfaqësojnë resurset më të rëndësishme natyrore të komunës. Duke qenë se ekonomia lokale mbështetet kryesisht në bujqësi intensive, ruajtja e këtyre sipërfaqeve ka rëndësi të veçantë mjedisore dhe ekonomike. Ndërhyrjet e paplanifikuara, si urbanizimi i pa-kontrolluar dhe praktikat bujqësore jo-të qëndrueshme, rrezikojnë të shkaktojnë ndryshime të strukturës së tokës dhe

ndotje të rëndë të burimeve ujore nëntokësore. Kjo situatë çon në degradimin e cilësisë së tokës dhe në humbjen e habitatit për bimësi dhe shtazë të ekuilibruar natyror.

Ujërat nëntokësore paraqesin një element veçanërisht të ndjeshëm mjedisor, duke qenë se përbëjnë burimin kryesor të furnizimit me ujë për popullsinë dhe aktivitetet bujqësore. Potenciali për infiltrimin e ndotësve nga ujërat e zeza, mbeturinat dhe aktivitetet bujqësore kërkon kontroll të vazhdueshëm dhe masa mbrojtëse gjatë planifikimit të zhvillimeve të ardhshme.

Sipërfaqet pyjore dhe vegjetacioni natyror kanë rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe ruajtjen e stabilitetit ekologjik. Edhe pse me shtrirje relativisht të kufizuar, këto zona përbëjnë habitate të rëndësishme natyrore dhe duhet të mbrohen nga degradimi dhe ndryshimi i pakontrolluar i përdorimit të tokës.

Zonat përgjatë lumit Toplluha, të ekspozuara ndaj vërshimeve, paraqesin gjithashtu zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Ndryshimet në përdorimin e tokës, ndërhyrjet në shtratin e lumit dhe zhvillimet e pakontrolluara në këto hapësira mund të rrisin rrezikun e degradimit të habitateve, humbjes së tokës bujqësore dhe dëmtimit të funksioneve natyrore të ekosistemit lumor.

6. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PZHk-së

6.1. DEKLARATA E VIZIONIT PËR KOMUNËN

Vizioni i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Mamushës është:

Mamusha është një komunë me perspektivë, me prodhim dhe përpunim të zhvilluar bujqësor, sektorë të ndryshëm të biznesit, të mbështetur nga një infrastrukturë adekuate dhe shërbime cilësore publike për banorët e saj në mënyrë që të gëzojnë një ambient të sigurt dhe të pastër për jetesë.

6.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHk SIPAS FUSHAVE TEMATIKE

6.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK

QËLLIMI 1	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik përmes zonës ekonomike dhe korridorit zhvillimor
Objektivi 1	Funksionalizimi i zonës ekonomike me infrastrukturë të plotë deri 2030.
Objektivi 2	Zhvillimi i korridorit ekonomik si bosht i aktiviteteve tregtare dhe shërbyese deri 2034.
Objektivi 3	Zhvillim i politikave për tërheqjen e investitorëve vendor dhe ndërkombëtar për investim në vazhdimësi.
QËLLIMI 2	Diversifikimi ekonomik përmes agro-turizmit dhe aktiviteteve rurale
Objektivi 1	Krijimi i rrugëve turistike (eco-trails, cycling routes), deri 2030.
Objektivi 2	Organizimi i eventeve lokale (festivale ushqimi, panaire), në vazhdimësi.
Objektivi 3	Branding i produkteve lokale (domate, produkte bujqësore).
QËLLIMI 3	Zhvillimi i një sistemi të ekonomisë qarkore në Komunën e Mamushës që redukton mbeturinat dhe rrit efikasitetin e burimeve, duke integruar bujqësinë, përpunimin dhe energjinë e rinovueshme deri në vitin 2034.
Objektivi 1	Reduktimi i mbetjeve organike bujqësore përmes kompostimit dhe ripërdorimit, duke arritur që të paktën 50% e mbetjeve bujqësore të trajtohen dhe ripërdoren deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme në sektorin bujqësor dhe ekonomik, duke instaluar sisteme solare në minimum 30% të fermave dhe bizneseve në zonën ekonomike deri në vitin 2034.
QËLLIMI 4	Rritja, zhvillimi dhe diversifikimi i sektorit të bujqësisë dhe agro industrisë në komunën e Mamushës
Objektivi 1	Rritja e aftësisë konkurruese në sektorin agro-ushqimor dhe kalimi në standardet e BE-së në prodhim dhe përpunim deri në vitin 2034, duke ngritur standarde kyçe të BE-së për produkte bujqësore.
Objektivi 2	Nxitja e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së zingjirit agro-ushqimor duke rritur numrin e fermave dhe nderlidhjen me kompanitë e përpunimit të produkteve agro-ushqimore me 50% deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Investime në infrastrukturën publike që mbështesin zhvillimin e tokave bujqësore, duke ndihmuar në rehabilitimin e 500 hektarëve, përmirësimin e rrugëve fushore dhe vendosjen e 200 ha të tokës bujqësore në sistem të ujitjes deri në vitin 2034.
Objektivi 4	Diversifikimi i 30% të fermave ekzistuese në sektorë të rinj të bujqësisë (si prodhimi i produkteve organike, serra, etj.) dhe krijimi i 500 vendeve të reja të punës deri në vitin 2034.
Objektivi 5	Krijimi i mundësive për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të shpeztaris, përmes krijimit të strategjive për mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e numrit të fermave të shpeztarëve me 25% deri në vitin 2034.
Objektivi 6	Konsolidimi i 40% të tokave bujqësore të shpërndara dhe nxitja e rritjes së efikasitetit të përdorimit të tyre deri në vitin 2034, përmes sistemeve të menaxhimit të tokave dhe mbështetje për fermerët.

6.2.2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

6.2.2.1. RRJETI I UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

QËLLIMI 1	Menaxhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijes për zonën e Mamushës, në të mirë të jetës së shëndetshme dhe mirëqenies
Objektivi 1	Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë të pijes brenda zonës së shërbimit deri në vitin 2028.
Objektivi 2	Përfundimi i projekteve të ujësjellësit për një shërbim më cilësor të qytetarëve brenda zonës së shërbimit deri në vitin 2028.
Objektivi 3	Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues për 25%, deri në vitin 2028.
Objektivi 4	Mbulueshmëria e zonës së shërbimit me rrjet të hidrantëve funksionalë deri në vitin 2033.
QËLLIMI 2	Menaxhimi dhe qasja e qëndrueshme në infrastrukturën e ujërave të zeza.
Objektivi 1	Zgjerimi i rrjetit të infrastrukturës ekzistuese të kanalizimit brenda zonës së shërbimit deri në vitin 2031.
Objektivi 2	Ndërtimi i kolektorit kryesor nga pikat shkarkuese deri te lokacioni për impiant deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura për Komunën e Mamushës.
Objektivi 4	Zgjerimi dhe revitalizimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik brenda zonës së shërbimit.
Objektivi 5	Vjelja, grumbullimi dhe ripërdorimi i ujërave të shiut për Komunën e Mamushës deri në vitin 2034.

6.2.2.2. ENERGJIA ELEKTRIKE

QËLLIMI 1	Rritja e eficiencës së energjisë dhe diversifikimi i prodhimit: Krijimi i mekanizmave për stimulimin e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme përmes granteve. Subvencionimi i izolimit të shtëpive duke reduktuar konsumin e energjisë elektrike për ngrohje, subvencionimi i paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar.
Objektivi 1	Zëvendësimi i transformatorëve të ngarkuar me transformator me fuqi më të lartë ose ndarje e ngarkesës përmes vendosjes së transformatorëve të rinjë duke bërë balancim të ngarkesave mes transformatorëve
Objektivi 2	Bashkëpunimi i autoriteteve komunale me KEDS-in në mënyrë që rrjeti 0.4 kV të kalojë nga rrjet ajror në rrjet kabllor, kjo bëhet edhe përmes bashkëpunimit me operatorët e telekomunikimeve ashtu që të eliminohet shpërndarja kaotike e kabllave nëpër shtylla ku në disa raste përfshihen edhe shtyllat e ndriçimit publik.
Objektivi 3	Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik, i cili përfshin të gjitha rrugët në Komunën e Mamushës, kjo duhet të bëhet duke krijuar një rrjet të mençur dhe eficient të ndriçimit publik.

6.2.2.3. ENERGJIA TERMIKE

QËLLIMI 1	Hulumtimi i mundësive për zhvillimin e sistemit të ngrohjes qendrore në Mamushë
Objektivi 1	Hartimi i një studimi të fizibilitetit për mundësit e ngrohjes qendrore të komunës në mënyrë të organizuar deri 2030.
Objektivi 2	Fillimi i zbatimit të projektit për ngrohje qendrore deri 2035.

6.2.2.4. TELEKOMUNIKIMI DHE INSTALIMET E NGJASHME

QËLLIMI 1	Zhvillimi i një infrastrukture moderne të telekomunikimit për të mundësuar transformimin digjital të komunës
Objektivi 1	Mbulim 100% me broadband (>100 Mbps) deri më 2029, përmes rrjeteve me fibra optike dhe/ose 5G.
Objektivi 2	Mbulim me 5G për të gjithë territorin deri më 2028.
Objektivi 3	Zbatimi i projekteve “Smart City” – instalimi i inteligjente i rrjeteve telekomunikuese deri 2034.

6.2.2.5. GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE

QËLLIMI 1	Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave
Objektivi 1	Deri në vitin 2030, të zgjerohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave urbane për të mbuluar 100% të territorit dhe banorëve të komunës.
Objektivi 2	Mbyllja dhe pastrimi i të gjitha deponive ilegale të identifikuara në komunë deri në vitin 2028, vendosja e sinjalizimeve të qarta ndaluese dhe masa mbikëqyrëse në këto lokacione për të parandaluar hedhjen e mëtejme.
Objektivi 3	Deri në fund të vitit 2027, të nisë një program pilot i ndarjes së mbetjeve në burim në institucionet publike dhe disa lagje, me synimin që të minimalisht 10% e mbetjeve urbane të riciklohen deri në vitin 2027.
Objektivi 4	Krijimi i një baze të dhënash mbi gjenerimin, grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin, si dhe inventarizimi i lokacioneve problematike deri në fund të vitit 2029.

6.2.3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

QËLLIMI 1	Përmirësimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor
Objektivi 1	Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale dhe periferike.
Objektivi 2	Përmirësimi i rrugëve fushore për nevojat e bujqësisë.
Objektivi 3	Përmirësimi i ndriçimit dhe sinjalizimit rrugor.
Objektivi 4	Vazhdimi i projekteve të planifikuara, si rruga “Bahçelik” dhe lidhjet Mamushë–Medvec–Nepërbisht.
Objektivi 5	Mirëmbajtja e rregullt e rrugëve ekzistuese.
QËLLIMI 2	Rritja e sigurisë rrugore
Objektivi 1	Përmirësimi i udhëkryqeve dhe qasjeve anësore në rrugën kryesore.
Objektivi 2	Vendosja dhe përmirësimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal.
Objektivi 3	Ndërtimi i vendkalimeve të sigurta për këmbësorë.
Objektivi 4	Vendosja e masave për qetësimin e trafikut në zonat urbane.
Objektivi 5	Përmirësimi i ndriçimit publik në rrugët periferike.
QËLLIMI 3	Zhvillimi i infrastrukturës për lëvizje të këmbësorëve dhe çiklistëve
Objektivi 1	Ndërtimi dhe rehabilitimi i trotuareve.
Objektivi 2	Lirimi i trotuareve nga parkimet ilegale.
Objektivi 3	Krijimi i kushteve për lëvizje të sigurt pranë shkollave dhe institucioneve.
Objektivi 4	Planifikimi gradual i shtigjeve për biçikleta.
Objektivi 5	Vendosja e sinjalizimit për lëvizjet jomotorike.
QËLLIMI 4	Përmirësimi i transportit publik
Objektivi 1	Përmirësimi i lidhjes ekzistuese me Prizrenin.
Objektivi 2	Krijimi i mundësive për linja të rregullta drejt Suharekës dhe Rahovecit.
Objektivi 3	Rregullimi i ndalesave të autobusëve përgjatë rrugës kryesore.
Objektivi 4	Pajisja e ndalesave me strehimore dhe sinjalizim adekuat.
QËLLIMI 5	Organizimi i parkimit
Objektivi 1	Identifikimi i hapësirave të përshtatshme për parkingje publike;
Objektivi 2	Rregullimi i parkimit pranë institucioneve, shkollave dhe tregut;
Objektivi 3	Ndalimi i parkimit në trotuare dhe vendkalime;
Objektivi 4	Vendosja e sinjalizimit për hapësirat e parkimit;
Objektivi 5	Krijimi i sistemit të kontrolluar të parkimit në zonën qendrore.

6.2.4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

6.2.4.1. SHËNDETËSIA DHE MIRËQENA SOCIALE

QËLLIMI 1	Jetë e shëndetshme dhe mirëqenia për të gjithë
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.2. ARSIMI

QËLLIMI 1	Arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë me infrastrukturë bashkëkohore shkollore dhe nxitje të mundësive për edukim gjatë gjithë jetës
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të institucioneve parashkollore konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033
Objektivi 2	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të institucioneve të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033
Objektivi 3	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të institucioneve të mesëm të ultë konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.3. ADMINISTRATA PUBLIKE

QËLLIMI 1	Zhvillimi i infrastrukturës administrative
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të institucioneve administrative konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.4. KULTURË, RINI DHE SPORT

QËLLIMI 1	Zhvillimi i infrastrukturës dhe shtimi i aktiviteteve kulturore dhe rinore
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të institucioneve kulturore konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.5. HAPËSIRAT REKREATIVE

QËLLIMI 1	Zhvillimi i infrastrukturës rekreative
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të hapësirave rekreative konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.6. HAPËSIRAT E KOMUNITETIT

QËLLIMI 1	Zhvillimi i hapësirave të komunitetit
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të hapësirave të komunitetit konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.7. HAPËSIRAT E HAPURA PUBLIKE

QËLLIMI 1	Zhvillimi i hapësirave të hapura publike
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të hapësirave të hapura publike konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.4.8. HAPËSIRAT E VARREZAVE PUBLIKE

QËLLIMI 1	Zhvillimi i hapësirave e varrezave publike
Objektivi 1	Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të hapësirave e varrezave publike konform kërkesave të Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor deri në vitin 2033

6.2.5. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Qëllimi 1	Përmirësimi i cilësisë së ujit në komunë duke eliminuar ndotjen e lumenjve dhe burimeve ujore nga ujërat e zeza, mbeturinat dhe kimikatet bujqësore
Objektivi 1	Pastrimi i shtratit dhe brigjeve të lumit nga mbeturinat e ngurta dhe eliminimi i deponive ilegale pranë rrjedhave ujore, deri në fillim të vitit 2028.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034, të zvogëlohet përdorimi i tepërt i pesticideve dhe plehrave kimike me 30% përmes trajnimit të fermerëve dhe promovimit të praktikave bujqësore ekologjike
Objektivi 3	Të realizohet monitorim i rregullt (të paktën çdo tremujor) i cilësisë së ujit të lumit Toplluha dhe i disa puseve kryesore private
Qëllimi 2	Ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit duke reduktuar burimet lokale të ndotjes atmosferike
Objektivi 1	Të sigurohet të paktën një mënyrë monitorimi e cilësisë së ajrit (stacion mobil ose matje periodeke) për të krijuar një bazë të të dhënave mbi nivelin e grimcave PM ₁₀ , PM _{2.5} dhe gazrave kryesore ndotës, deri në fund të vitit 2027.
Objektivi 2	Ulja me 50% e përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje në amvisëritë e Mamushës, zëvendësimi me alternativa më të pastra, deri më 2034.
Objektivi 3	Të ndalohet plotësisht djegia e mbeturinave në ambient të hapur dhe e mbetjeve bujqësore deri në fund të vitit 2027.
Qëllimi 3	Mbrojtja dhe rikthimi i cilësisë së tokës në komunë, me fokus tek tokat bujqësore pjellore, parandalimi i kontaminimit, rehabilitimi i zonave të ndotura dhe menaxhimi i qëndrueshëm i përdorimit të tokës
Objektivi 1	Identifikimi dhe sanimi i të gjitha vend-depozitimeve ilegale të mbeturinave në territorin e komunës, rikultivimi i tyre, deri në vitin 2028.
Objektivi 2	Studim i plotë i cilësisë së tokës bujqësore në Mamushë deri në fund të vitit 2028, duke përfshirë analiza laboratorike për ndotës potencialë (metalet e rënda, pesticide të mbetura, etj.) në mostrat përfaqësuese
Objektivi 3	Të realizohet projekt i posaçëm për parandalimin e erozionit dhe vërshimeve përgjatë lumit Toplluha dhe tokave pranë tij, duke mbrojtur tokën bujqësore nga degradimi, deri në vitin 2032.
Qëllimi 4	Ruajtja dhe rikuperimi i biodiversitetit lokal dhe i habitateve natyrore në komunën e Mamushës, integrimi i parimeve të konservimit në zhvillimin rural
Objektivi 1	Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Lokale për Ruajtjen e Biodiversitetit në Mamushë, deri në vitin 2028, identifikimi i zonave dhe llojeve kyçe për mbrojtje si dhe masat prioritare për menaxhimin e tyre.
Objektivi 2	Deri në vitin 2030, të rritet minimalisht me 20% sipërfaqja e mbuluar me drunj dhe gjelbërim në komunë, nëpërmjet fushatave të pyllëzimit dhe krijimit të hapësirave të gjelbra publike
Objektivi 3	Duke filluar menjëherë, të zbatohet një kontroll i rreptë mbi prerjen e drunjëve në komunë, në mënyrë që prerjet ilegale të reduktohen me 80% brenda dy viteve
Objektivi 4	Vendosja e një brezi mbrojtës (të paktën 5 km) përgjatë lumit Toplluha brenda territorit të komunës, ku ndalohet ndërtimi dhe përdorimi intensiv bujqësor shumë pranë lumit, për ruajtjen e ekosistemit lumor, deri në vitin 2028.
Qëllimi 5	Mbrojtja dhe reagimi ndaj fatkeqësive natyrore dhe qëndrueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike
Objektivi 1	Hartëzimi dhe dokumentimi i zonave të rrezikuara nga përmybtjet, erozioni dhe rreziqe të tjera natyrore deri në fund të 2028.
Objektivi 2	Përfundimi i projekti për rregullimin e shtratit të lumit Toplluha, përfshirë pastrimin, thellimin dhe ndërtimin e mureve mbrojtëse, deri në vitin 2030.
Objektivi 3	Krijimi i një mekanizmi për raportimin dhe regjistrimin e rasteve të fatkeqësive natyrore i integruar në sistemin e menaxhimit të rrezikut në nivel lokal, deri në vitin 2028.
Objektivi 4	Deri në vitin 2030, të hartohet dhe miratohet Plani Komunal për Menaxhimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore.

6.2.6. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE

QËLLIMI 1	Ruajtja dhe konservimi aktiv /rigejenerimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si pasuri e çmuar territorial dhe vlerë e përbashkët e njezimit.
Objektivi 1	Planifikimi i integruar për konservimi/rigjenerim të sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, dhe restaurim dhe adaptim të monumenteve për përdorim bashkëkohor, në përputhje me rregullat dhe standardet profesionale.
Objektivi 2	Sistemi i dokumentimit, informimit, promovimi, ngritja e vetëdijes për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, drejt zhvillimit të turizmit kulturore dhe ekosistemit.
Objektivi 3	Sistemi i mirëmbajtjes dhe investimet sistematike për asete të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në funksion të dobisë ekologjike, shoqërore, kulturore dhe ekonomike.

6.2.7. VENDBANIMET

QËLLIMI 1	Zhvillimi i harmonizuar i vendbanimit urban
Objektivi 1	Balancimi i investimeve dhe qasjes në shërbime në zonën urbane.
Objektivi 2	Hartimi i planeve rregulluese të hollësishme.
QËLLIMI 2	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe infrastrukturës
Objektivi 1	Rritja e qasjes në rrugë, ujësjellës, kanalizim dhe ndriçim publik.
Objektivi 2	Zhvillimi i qendrave multifunksionale në vendbanim.
QËLLIMI 3	Legalizimi i drejtë dhe funksional i ndërtimeve pa leje
Objektivi 1	Identifikimi i të gjitha ndërtimeve pa leje dhe krijimi i Regjistrit të ndërtimeve pa leje me ndarje sipas lokacionit dhe funksionit, deri me 2034
Objektivi 2	Aplikimi i kriterëve të legalizimit të bazuara në siguri, mjedis dhe pronësi, deri me 2034
QËLLIMI 4	Parandalimi i ndërtimit të ri pa leje
Objektivi 1	Forcimi i inspektoratit dhe vendosja e sanksioneve efektive, deri me 2034
Objektivi 2	Rritja e transparencës në procesin e dhënies së lejeve për ndërtim, deri me 2034
QËLLIMI 5	Integrimi i ndërtimeve të legalizuara në sistemin urban dhe infrastrukturë
Objektivi 1	Përditësimi i planeve urbanistike dhe investime në rrjetet infrastrukturorë për ndërtimet e legalizuara, deri me 2034
QËLLIMI 6	Digjitalizimi dhe monitorimi
Objektivi 1	Funksionalizimi i plotë i sistemit GIS dhe platformës digjitale për legalizim dhe monitorim, deri me 2034
Objektivi 2	Krijimi i Njesisë për Legalizim dhe Zhvillim të Integruar në kuadër të komunës, deri me 2034
QËLLIMI 7	Përfshirja e komuniteteve në proces
Objektivi 1	Angazhimi i komunitetit në planifikim për 100% të zonave me ndërtime pa leje, deri me 2034

6.2.8. VENDBANIMET JO FORMALE

QËLLIMI 1	Integrimi i vendbanimit joformal në strukturën zyrtare të planifikimit, respektivisht Eliminimi i strehimit joformal dhe sigurimi i banimit të dinjitetshëm për të gjithë
Objektivi 1	Evidentimi dhe kategorizimi në bazë të kriterëve teknike dhe ligjore, deri në 2034
Objektivi 2	Hartimi i planit rregullues për integrimin gradual, deri në 2034
QËLLIMI 2	Përmirësimi i kushteve socio-ekonomike dhe inkluzionit shoqëror të komuniteteve të prekura dhe Reduktimi i pabarazive socio-hapësinore në vendbanime joformale
Objektivi 1	Investime në infrastrukturë bazë, ashtu që familjet të kenë mundësi të barabarta për mirëqenie, deri në 2034
Objektivi 2	Përfshirje aktive e banorëve në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes.
Objektivi 3	Banorët e dikurshëm të vendbanimeve joformale të kenë përfaqësues të tyre (formal ose joformal) në mekanizmat konsultativë komunal, deri në 2034
QËLLIMI 3	Legalizimi i Vendbanimit joformal
Objektivi 1	Legalizimi dhe paisja me dokumente pronësie 100% e njësive të banimit në kuadër të VJF, deri në 2034
Objektivi 2	Ofrimi i mbështetjes për legalizimin dhe formalizimin e pronës, deri në 2034
QËLLIMI 4	Integrimi hapësinor dhe infrastrukturor i zonave të rehabilituara me qytetin
Objektivi 1	Integrim funksional dhe estetik në zonat respektive të Mamushës, deri në 2034
Objektivi 2	Infrastruktura publike – shtrirja e rrjetit rrugor, ujsjellsit dhe kanalizimit deri në 2034
Objektivi 3	Infrastruktura ambientale- Rehabilitimi mjedisor i truallit të liruar, deri në 2034
Objektivi 4	Mobiliteti - Sigurimi i lidhjes së transportit publik dhe rregullimi i qasjes (trotuare, ndriçim) , deri në 2034

6.2.9. BANIMI




QËLLIMI 1	Zhvillimi i banimit të kontrolluar dhe kompakt
Objektivi 1	Orientimi i zgjerimit të banimit drejt zonave të përshtatshme hapësinore dhe infrastrukturore
Objektivi 2	Parandalimi i zgjerimit të pakontrolluar horizontal
Objektivi 3	Konsolidimi i zonës ekzistuese të banimit përmes planifikimit të detajuar
Objektivi 4	Ruajtja e tokës bujqësore dhe kufizimi i ndërtimeve të shpërndara
QËLLIMI 2	Përmirësimi i cilësisë së jetesës në lagjet ekzistuese
Objektivi 1	Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, ndriçimit publik dhe rrugëve lokale
Objektivi 2	Krijimi i hapësirave publike, gjelbërimit dhe zonave rekreative
Objektivi 3	Sigurimi i parkingjeve, trotuareve dhe qasjes së sigurt për këmbësorë
Objektivi 4	Përmirësimi i kushteve për persona me aftësi të kufizuara
QËLLIMI 3	Banimi i përballueshëm dhe social
Objektivi 1	Identifikimi i nevojave reale për banim social dhe të përballueshëm
Objektivi 2	Krijimi i një regjistri komunal për familjet dhe individët në nevojë për strehim
Objektivi 3	Shfrytëzimi i mundshëm i njësive të zbrazëta ose të papërfunduara për qëllime sociale
Objektivi 4	Sigurimi i tokës komunale ose partneriteteve për ndërtim me kosto të përballueshme
QËLLIMI 4	Qëndrueshmëria mjedisore dhe efikasiteti energjetik
Objektivi 1	Promovimi i ndërtimeve me standarde më të mira energjetike
Objektivi 2	Nxitja e përdorimit të izolimit termik, paneleve solare dhe materialeve të qëndrueshme
Objektivi 3	Ulja e konsumit të energjisë në objektet e banimit
Objektivi 4	Përmirësimi i raportit ndërmjet hapësirave të ndërtuara dhe hapësirave të hapura

6.2.10. SHFRYTËZIMI I TOKËS

QËLLIMI 1	Menaxhimi i qëndrueshëm dhe racional i shfrytëzimit të tokës
Objektivi 1	Harmonizimi i kufijve ndërtimor me projeksionet reale demografike dhe nevojat për banim.
Objektivi 2	Rishikimi dhe racionalizimi i sipërfaqeve të planifikuara për banim, veçanërisht në zonat ku zhvillimi nuk është realizuar sipas projeksioneve.
Objektivi 3	Parandalimi i zhvillimit të shpërndarë dhe orientimi drejt formave më kompakte të zhvillimit urban.
QËLLIMI 2	Ruajtja dhe mbrojtja e tokës bujqësore si resurs strategjik zhvillimor
Objektivi 1	Mbrojtja e tokave bujqësore me produktivitet të lartë (kategoritë I-IV) nga urbanizimi i pakontrolluar, në vazhdimësi.
Objektivi 2	Orientimi i zgjerimeve ndërtimore në toka me kapacitet më të ulët prodhues dhe në përputhje me nevojat reale.
Objektivi 3	Promovimi i komasacionit (konsolidimit) të parcelave bujqësore për rritjen e efikasitetit të prodhimit bujqësor.
QËLLIMI 3	Përmirësimi i cilësisë së banimit dhe organizimit hapësinor i vendbanimit
Objektivi 1	Krijimi i zonave të banimit më cilësore dhe më të qëndrueshme me qasje në hapësira publike, gjelbërim dhe rekreim
Objektivi 2	Promovimi i densifikimit të kontrolluar në zonat ekzistuese urbane si alternativë ndaj zgjerimit të shpërndarë
Objektivi 3	Integrimi i standardeve për zhvillim më të mirë të infrastrukturës dhe shërbimeve në zonat e banimit.
QËLLIMI 4	Balancimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe mjedisor në territor
Objektivi 1	Planifikimi i sipërfaqeve për zhvillim komercial dhe ekonomik në harmoni me potencialin bujqësor të komunës;
Objektivi 2	Harmonizimi i zhvillimit të infrastrukturës rugore me kategoritë e tjera të shfrytëzimit të tokës;
Objektivi 3	Ruajtja dhe rigenerimi i sipërfaqeve pyjore dhe mbrojtja e tyre nga degradimi dhe zjarret.

6.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Në kuadër të PZHK-së së Komunës së Mamushës janë shqyrtuar tre skenarë hapësinorë, me qëllim analizimin e alternativave të mundshme të zhvillimit territorial, ekonomik, social dhe mjedisor. Skenarët janë përdorur si instrument për vlerësimin e drejtimeve të zhvillimit dhe ndikimeve të mundshme në shfrytëzimin e tokës, infrastrukturë, resurse natyrore dhe cilësi të mjedisit. Të tre skenarët kanë një parim të përgjithshëm të zhvillimit hapësinor të Mamushës, një komunë me territor rrafshinor, që kërkon të ndërtohet mbi një model të rritjes kompakte, ku për dallim nga skenari 1 dhe 3 që promovojnë shpërndarje hapësinore të zhvillimeve, skenari 2 mbështetë një zhvillim me intensitet më të ulët dhe më miqësor me mjedisin.

Skenari	Koncepti zhvillimor	Implikimet mjedisore
 <p>I. Skenari i integruar territorial</p>	<p>Mbështetet në konceptin e PZHK-së 2013–2023 dhe ndarjen e territorit në zona funksionale: zonë vendbanimi, tokë bujqësore, zona kodrinore/pyjore dhe zona për zhvillim ekonomik. Synon zhvillim kompakt rreth infrastrukturës ekzistuese, përmirësim të shërbimeve publike dhe zhvillim të bujqësisë si shtyllë kryesore ekonomike.</p>	<p>Mundëson përdorim racional të resurseve lokale dhe përfshin krijimin e zonave tampon përgjatë lumit, rrugëve dhe aktiviteteve ekonomike. Megjithatë, si skenar i bazuar në dokumentin e mëparshëm, ka kufizime në përshtatjen me zhvillimet aktuale dhe kërkesat e reja hapësinore.</p>
 <p>II. Skenari për zhvillim të qëndrueshëm, të orientuar në bujqësi, turizëm rural dhe mbrojtje mjedisore</p>	<p>Qasje e balancuar dhe të orientuar drejt mbrojtjes së mjedisit, duke vendosur bujqësinë dhe turizmin rural si shtylla kryesore të zhvillimit. Parasheh mbrojtje strikte të tokës bujqësore, zhvillim të kontrolluar, agroturizëm dhe ruajtje të burimeve ujore e zonave pyjore.</p>	<p>Është skenari më miqësor me mjedisin, me ndikim pozitiv në ruajtjen e tokës bujqësore, biodiversitetit dhe korridoreve ekologjike. Kufizimi kryesor lidhet me ritmin më të ngadalshëm të zhvillimit ekonomik dhe varësinë më të lartë nga sektorët tradicional.</p>
 <p>III. Skenari për zhvillim kompakt dhe i ndërlidhur</p>	<p>Paraqet model të integruar zhvillimi, i cili kombinon rritjen ekonomike, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Zhvillimi orientohet përgjatë korridoreve zhvillimore dhe nyjeve urbane, me diversifikim ekonomik përmes bujqësisë, shërbimeve, tregtisë, turizmit dhe energjisë së rinovueshme.</p>	<p>Ofron balancë ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit, përmes integritit të zonave të gjelbra, korridoreve ekologjike, hapësirave rekreative, menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave dhe mbetjeve. Rreziqet kryesore lidhen me presionin potencial mbi tokën bujqësore dhe nevojën për menaxhim të kontrolluar institucional.</p>

Bazuar në vlerësimin e përparësive dhe mangësive të skenarëve, Skenari III është përcaktuar si skenar bazë për zhvillimin e mëtejshëm.

6.3.1. ASPEKTE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE

Diskutimi i të dhënave bazë është të identifikojë gjendjen mjedisore në raport me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Planit Zhvillimor Komunal të Mamushës. Ndikimet potenciale të zhvillimeve të ardhshme duhen vlerësuar për nga evolucioni i mundshëm, me ose pa implementimin e planit, përmes indikatorëve të gjendur/supozuar sasiorë ose cilësorë. Në thelb, gjendja mjedisore e komunës karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisorë, në pëpëthje me kërkesat e Direktivës mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, si: biodiversiteti, popullsia, shëndeti publik, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimatikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, peizazhi dhe ndërlidhja midis faktorëve të mësipërm.

6.3.2. POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK

Ndikimet në shëndetin publik, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë të tilla si ajri, uji apo toka dhe nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial përmes transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prania e deponive ilegale dhe përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta për ngrohje paraqesin faktorë potencialë që mund të ndikojnë në cilësinë e jetës dhe shëndetin e popullsisë.

Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin

Më poshtë janë identifikuar disa ndikime që lidhen me shëndetin në tërësi:

- Përmirësimi i sistemit të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza;
- Eliminimi i deponive ilegale dhe zgjerimi i mbulimit me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;
- Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore nga ndotja;
- Ruajtja e tokave bujqësore me bonitet të lartë nga degradimi dhe ndryshimi i pakontrolluar i përdorimit të tokës;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i pesticideve dhe plehrave kimike në aktivitetet bujqësore;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit përmes rritjes së efikasitetit energjetik dhe reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse me ndikim të lartë në mjedis;
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra dhe korridoreve ekologjike përgjatë rrjedhave ujore;
- Zbatimi i masave për mbrojtjen nga vërshimet dhe reduktimin e proceseve erozive;
- Përmirësimi i monitorimit të parametrave mjedisorë, veçanërisht për cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës;
- Integrimi i konsideratave mjedisore dhe shëndetësore në planifikimin e zhvillimeve të ardhshme urbane, ekonomike dhe infrastrukturore.

6.3.3. VEÇORITË NATYRORE KRYESORE TË KOMUNËS DHE ZONAT QË NDIKOHEN

Në seksionet paraprake janë paraqitur karakteristikat natyrore të Komunës së Mamushës, të cilat dominohen nga tokat bujqësore me bonitet të lartë, rrjeti hidrografik i përfaqësuar kryesisht nga lumi Toplluha dhe lumi Tërn, burimet ujore nëntokësore dhe sipërfaqe të kufizuara pyjore dhe kodrinore në pjesët periferike të territorit, resurse të cilat përbëjnë bazën kryesore të zhvillimit ekonomik dhe mjedisor të komunës. Nga analiza e gjendjes ekzistuese dhe e tendencave të zhvillimit rezulton se tokat bujqësore paraqesin elementin më të rëndësishëm dhe njëkohësisht më të ndjeshëm të territorit komunal. Presioni nga zgjerimi i ndërtimit, fragmentimi i parcelave dhe ndryshimi i përdorimit të tokës paraqesin rrezik për reduktimin gradual të sipërfaqeve me vlerë të lartë prodhuese. Ruajtja e këtyre sipërfaqeve konsiderohet me rëndësi të veçantë për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës dhe për sigurinë afatgjatë të prodhimit bujqësor.

Burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore paraqesin gjithashtu komponentë të ndjeshëm mjedisorë. Lumi Toplluha dhe rrjedhat e tjera ujore ndikohen nga shkarkimi i ujërave të zeza, aktivitetet bujqësore dhe deponimi i pakontrolluar i mbeturinave, ndërsa ujërat nëntokësore janë të ekspozuara ndaj rrezikut të ndotjes për shkak të ndjeshmërisë së lartë të akuiferëve në pjesë të konsiderueshme të territorit komunal. Sipërfaqet pyjore dhe vegjetacioni natyror në zonat kodrinore, megjithëse me shtrirje të kufizuar, kanë rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin ekologjik dhe mbrojtjen e tokës nga proceset erozive. Ndryshimet në përdorimin e tokës dhe degradimi i vegjetacionit mund të ndikojnë negativisht në këto funksione ekologjike.

Një kategori e veçantë e zonave që ndikohen janë hapësirat përgjatë lumit Toplluha, të cilat përballen me rrezik periodik nga vërshimet. Këto zona kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen e funksioneve natyrore të ekosistemit lumor, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe reduktimin e rrezikut ndaj vendbanimeve dhe infrastrukturës.

Në përgjithësi, veçoritë natyrore të Komunës së Mamushës karakterizohen nga ndërlidhja e ngushtë ndërmjet tokës bujqësore, burimeve ujore dhe peizazhit rural, ruajtja e të cilave është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor dhe për mbrojtjen e vlerave mjedisore të komunës.

6.3.4. ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS

Duke u bazuar në karakteristikat territoriale, strukturën e vendbanimeve, potencialin bujqësor, resurset natyrore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, PZHK i Mamushës përcakton zonat kryesore të zhvillimit dhe mbrojtjes.

ZONAT E NDËRTIMIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

PZHK orienton zhvillimin urban kryesisht brenda dhe në vazhdimësi të strukturës ekzistuese të vendbanimit, duke promovuar zhvillim kompakt, densifikim të zonave të ndërtuara dhe shfrytëzim më efikas të infrastrukturës ekzistuese. Zhvillimi i ri planifikohet të përqendrohet përgjatë korridoreve kryesore zhvillimore dhe në nyjet urbane të identifikuar, me qëllim shmangien e zgjerimit të pakontrolluar në tokat bujqësore.

ZONAT BUJQËSORE

PZHK parashikon mbrojtjen e sipërfaqeve me bonitet të lartë, promovimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe kufizimin e shndërrimit të tokës bujqësore në përdorime të tjera, me qëllim zhvillimin ekonomik, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit.

ZONAT EKONOMIKE

PZHK parashikon zhvillimin e aktiviteteve ekonomike përgjatë korridorit kryesor zhvillimor, duke mundësuar diversifikimin e ekonomisë lokale përmes bujqësisë, tregtisë, shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera ekonomike. Vendosja e këtyre funksioneve synon të minimizojë konfliktet me përdorimet tjera të tokës dhe të sigurojë efikasitet më të lartë funksional dhe të territorit.

ZONAT REKREATIVE DHE TURIZMI RURAL

PZHK promovon zhvillimin e turizmit rural dhe agro-turizmit, duke u mbështetur në peizazhin rural, aktivitetet tradicionale dhe resurset natyrore të komunës. Në zona të përshtatshme planifikohen aktivitete rekreative, bujtina, ferma turistike dhe forma të tjera të zhvillimit turistik të integruar me mjedisin natyror dhe karakterin rural të territorit.

ZONAT E GJELBRA DHE KORRIDORET EKOLOGJIKE

PZHK parashikon ruajtjen dhe zhvillimin e sipërfaqeve pyjore, hapësirave të gjelbra dhe korridoreve ekologjike, veçanërisht përgjatë rrjedhave ujore dhe në pjesët kodrinore, për rolin e rëndësishëm që kanë këto zona në ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen nga erozioni, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe krijimin e kushteve për rekreacion. Planifikohet forcimi i rrjetit të gjelbër përmes lidhjes së hapësirave natyrore me zhvillimet e reja infrastrukturore dhe urbane.

ZONAT ME FUNKSIONE MBROJTËSE

PZHK trajton lumenjtë, zonat e ekspozuara ndaj vërshimeve, burimet ujore dhe zonat me vlera natyrore si hapësira me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e mjedisit. Në këto zona parashihen kufizime të zhvillimit dhe masa mbrojtëse me qëllim ruajtjen e funksioneve ekologjike, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe mbrojtjen e resurseve natyrore të komunës.

6.3.5. ÇËSHITJE MJEDISORE QË LIDHEN ME MJEDISIN FIZIK

Zhvillimet e ardhshme duhen harmonizuar me kapacitetet mjedisore të territorit, duke shmangur presionin mbi tokat bujqësore, burimet ujore dhe zonat e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore.

- Identifikimi dhe mbrojtja e zonave të ekspozuara ndaj vërshimeve përgjatë lumit Toplluha dhe rrjedhave të tjera ujore;
- Të parashihen masa për mbrojtjen e tokës nga proceset erozive dhe degradimi;
- Mbrojtja e tokës bujqësore me bonitet të lartë nga shndërrimi për përdorime të tjera;
- Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat e zeza, mbeturinat dhe aktivitetet bujqësore;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave dhe eliminimi i deponive ilegale;
- Ruajtja e korridoreve ekologjike përgjatë rrjedhave ujore dhe zonave me vegetacion natyror;
- Të integrohen masa për mbrojtjen nga rreziqet natyrore në projektet infrastrukturore dhe zhvillimore.

ÇËSHITJE MJEDISORE QË LIDHEN ME BIODIVERSITETIN, FLORËN DHE FAUNËN

- Ruajtja e habitateve natyrore dhe korridoreve ekologjike përgjatë rrjedhave ujore;
- Parandalimi i degradimit të sipërfaqeve pyjore dhe vegetacionit natyror;
- Kufizimi i ndërhyrjeve që mund të shkaktojnë fragmentimin e habitateve natyrore;
- Integrimi i masave për mbrojtjen e biodiversitetit në projektet infrastrukturore dhe zhvillimore;
- Promovimi i pyllëzimit dhe shtimit të sipërfaqeve të gjelbra si masë për përmirësimin e funksioneve ekologjike dhe peizazhore.

PLANIFIKIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS DHE ÇËSHITJE TË SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE

- Kufizimi i zgjerimit të zhvillimit në tokat bujqësore me bonitet të lartë;
- Ruajtja dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe korridoreve ekologjike;
- Harmonizimi i zhvillimeve të reja me kapacitetet infrastrukturore dhe mjedisore;
- Zbatimi i kriterëve mjedisore gjatë planifikimit të zhvillimeve urbane, ekonomike dhe infrastrukturore.

RREZIQET NATYRORE NË MJEDISIN FIZIK

Rreziku kryesor natyror në territorin e Komunës së Mamushës lidhet me vërshimet përgjatë lumit Toplluhë, ndërsa në pjesë të caktuara të territorit paraqitet ndjeshmëri ndaj proceseve erozive. Komuna ndodhet gjithashtu në zonë me rrezik sizmik të kategorisë VII MCS.

6.3.6. MJEDISI I NDËRTUAR DHE KULTURA

CILËSIA E AJRIT

Vlerësimi i cilësisë së ajrit kufizohet nga mungesa e një stacioni lokal monitorues. Si rrjedhojë, cilësia e ajrit bazohet në të dhënat e stacionit më të afërt monitorues në Prizren. Në përgjithësi, komuna nuk karakterizohet nga burime të mëdha industriale të ndotjes së ajrit, ndërsa presionet kryesore lidhen me aktivitetet e përditshme të popullsisë dhe sistemet individuale të ngrohjes.

Përgjithësisht, po rëndisim disa faktorë të cilët kanë ndikim në cilësinë e ajrit:

- Komunikacioni rrugor dhe emetimet nga automjetet;
- Përdorimi dominant i drurit për ngrohje gjatë sezonit dimëror;
- Përdorimi i qymyrit dhe lëndëve të tjera djegëse në raste të veçanta;
- Djegia e pakontrolluar e mbetjeve dhe biomasës;
- Emetimet e pluhurit nga aktivitetet ndërtimore dhe transporti.

Të dhënat e monitorimit nga stacioni i Prizrenit tregojnë se koncentrimet e PM₁₀, PM_{2.5}, NO₂, SO₂, CO dhe O₃ gjatë viteve të fundit kanë mbetur nën vlerat kufitare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta për ngrohje dhe mungesa e monitorimit lokal paraqesin faktorë që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme në aspektin e mbrojtjes së cilësisë së ajrit.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit kërkon monitorim më të avancuar të parametrave mjedisor, promovim të formave më efikase të ngrohjes, rritje të sipërfaqeve të gjelbra dhe masa për reduktimin e emetimeve nga sektori i transportit dhe aktivitetet e tjera antropogjene. Gjithashtu, integrimi i korridoreve të gjelbra dhe hapësirave publike të gjelbëruara në zhvillimet e ardhshme paraqet një mekanizëm të rëndësishëm për përmirësimin e kushteve mjedisore dhe cilësisë së jetesës në komunë.

ZHURMA

Ndotja akustike në Komunën e Mamushës lidhet kryesisht me trafikun rrugor, aktivitetet ekonomike lokale dhe përdorimin e mekanizimit bujqësor. Për shkak të karakterit kryesisht rural të komunës dhe mungesës së industrive të rënda, nuk identifikohen burime të mëdha të zhurmës me ndikim të gjerë territorial.

Aktualisht në komunë mungon një sistem monitorimi i zhurmës, si dhe të dhëna të strukturuar mbi nivelet e emetimeve akustike. Mungesa e sistemeve të matjes paraqet një sfidë në vlerësimin e saktë të emetimeve të zhurmës. Direktiva evropiane për zhurmën mjedisore kërkon nga autoritetet vendore të vlerësojnë nivelet e zhurmës në mjedisin e tyre lokal, të përmbushin treguesit e përbashkët të zhurmës dhe të hartojnë plane veprimi për të parandaluar ose zvogëluar efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Në këtë aspekt, është e nevojshme zhvillimi i strategjive me objektivin kryesor për reduktimin e zhurmës në fushat e mëposhtme:

- Zvogëlimi i densitetit të trafikut;
- Zvogëlimi i përqindjes së mjeteve të rënda të mallrave;
- Ulje e shpejtësive;
- Renovimi i transportit publik dhe automjeteve (të rënda) të mallrave;
- Ndërrimi i sipërfaqeve të rrugës etj.;
- Shqyrtimi i zhurmës;

- Dritare rezistente ndaj zërit;
- Krijimi i rregulloreve dhe standardeve për aktivitetet/burimet që emetojnë zhurmë;
- Investime në sistemet e matjes së nivelit të zhurmës.

BURIMET UJORE

Duke marrë parasysh karakterin bujqësor të territorit dhe varësinë e popullsisë nga ujërat nëntokësore, burimet ujore paraqesin një nga resurset më të rëndësishme natyrore të komunës, Megjithatë, vlerësimi i gjendjes së tyre paraqet vështirësi për shkak të mungesës së të dhënave të plota dhe të vazhdueshme mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Megjithëse lumi Toplluha përfshihet në rrjetin shtetëror të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore, të dhënat e disponueshme për territorin e komunës janë të kufizuara dhe nuk mundësojnë një vlerësim të detajuar të gjendjes ekologjike dhe kimike të trupave ujqore. Si rrjedhojë, ekziston pasiguri lidhur me shkallën reale të ndikimit nga ujërat e zeza, aktivitetet bujqësore dhe burimet e tjera potenciale të ndotjes. Një çështje me rëndësi të veçantë mbetet mbrojtja e ujërave nëntokësore, burimin kryesor të furnizimit me ujë në komunë. Duke qenë se pjesë të konsiderueshme të territorit karakterizohen nga ndjeshmëri e lartë ndaj ndotjes së akuiferëve, mungesa e monitorimit sistematik paraqet kufizim të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut mjedisor dhe planifikimin e masave mbrojtëse.

Në këtë kontekst, sfida kryesore nuk lidhet vetëm me burimet potenciale të ndotjes, por edhe me mungesën e informacionit të mjaftueshëm mbi gjendjen reale të resurseve ujore.

PRODHIMI I ENERGJISË SOLARE

PZHK i Komunës së Mamushës promovon përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të ndikimeve negative në mjedis. Në kuadër të skenarëve të zhvillimit, energjia solare konsiderohet si një nga alternativat me potencial për rritjen e efikasitetit energjetik dhe reduktimin e varësisë nga burimet konvencionale të energjisë.

Nuk hasen zona të identifikuar konkretisht për prodhimin e energjisë solare, megjithatë, vendosja e kapaciteteve të tilla duhet të harmonizohet me kriteret e mbrojtjes së tokës bujqësore, peizazhit dhe resurseve natyrore të komunës.

Në rast të planifikimit të projekteve konkrete për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, rekomandohet që ato t'i nënshtrohen vlerësimeve përkatëse mjedisore, me qëllim shmangien e ndikimeve të mundshme në përdorimin e tokës, biodiversitetin dhe karakterin rural të territorit.

7. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE

7.1. OBJEKTIVAT E VSM

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë PZHK-së së Komunës së Mamushës, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Objektivat mjedisore qëndrojnë po njëllor për planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale.

Vlerësimi realizohet për secilën nga Objektivat Mjedisore të listuara më poshtë:

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri:

Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë (p.sh., duke promovuar çiklizmin dhe përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian);

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji:

Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin, përmirësimi ruajtja e aftësisë për të deponuar ujin, minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit;

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka:

Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullosave);

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti:

Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemo-relikte të rralla dhe të kërcënuara;

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet:

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetë-ripërtitëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike;

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet:

Revitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike:

Ndërtimi i infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike, reduktimi i emetimeve të gazrave sere duke promovuar mobilitetin urban, çiklizmin dhe ecjen;

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore:

Konservimi e restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Shëndeti:

Përmirësimi i shëndetit të popullatës njerëzore, garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut natyror;

Objektivi Mjedisor 10 (OM10) – Social-ekonomik:

Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe ekonomike të komunitetit në përputhje me qëllimet e mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë zhvillimin e projekteve dhe politikave të qëndrueshme, rritjen e përfitimeve të komunitetit nga burimet natyrore, dhe promovimin e përdorimit të teknologjive mjedisore në prodhim dhe konsum;

Objektivat e mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritjen e sigurisë, ofrimin e mundësive për mënyrë aktive jetese, shtimin i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimin i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si Parimi i Subsidiaritetit që konsiston në ofrimin e shërbimeve publike, infrastrukturore, sociale dhe mjedisore sa më afër qytetarit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës, reduktimin e kostove të qasjes në shërbime dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm territorial.

7.2. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme të planifikimit hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;

4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi pagan” ose „përdoruesi pagan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesimi i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së, parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufinjve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më efektiv të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – aksesimi nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Ri-zhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

7.3. QËLLIMET STRATEGJIKE

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva globale dhe në objektiva të nivelit lokal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të definojnë si:

- Zhvillimi i përmirësuar, ku të gjithë aktorët kanë të drejtën për informacion, të dëgjohen, të ndikojnë dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes, me ndikim në jetën dhe të ardhmen e tyre. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, zhdukjen e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj.);
- Zhvillimi i partneritetit global për zhvillim.

Qëllimet strategjike të mësipërme synojnë të sigurojnë pjesëmarrje të përfshirë dhe të drejtën për informim për të gjithë aktorët e interesuar, duke i lejuar ata të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë rol aktiv në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Fokus në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe ndryshime në strukturën sociale dhe ekonomike, duke përfshirë zhvillimin e barabartë në nivel komunal për të siguruar të ardhme të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë banorët.

Qëllimet hartohen në përpjekje për të krijuar kushte për përmbushjen e nevojave themelore duke garantuar qasje të barabartë në shërbimet dhe burimet e nevojshme. Gjithashtu ato ofrojnë përpjekje për sigurimin e arsimit bazë, sigurinë sociale dhe fizike si dhe sigurinë e mjedisit për të garantuar një mjedis të qetë dhe të sigurt.

PZHK parashikon një qasje integrale për zhvillimin e territorit të Komunës së Mamushës, duke u bazuar në konceptin e zhvillimit kompakt dhe të ndërlidhur. Dokumenti përcakton kriteret, intensitetet, standardet dhe drejtimet e zhvillimit hapësinor për të gjithë territorin komunal, duke harmonizuar nevojat për zhvillim ekonomik, përmirësim të infrastrukturës, mbrojtje të tokës bujqësore dhe ruajtje të vlerave mjedisore.

Duke qenë se PZHK fokusohet në përcaktimin e një strategjie të përgjithshme dhe standardeve të përbashkëta për zhvillimin në tërësinë e komunës, në këtë pikë, hartohen Planet Rregulluese të Hollësishme, të cilat specifikojnë detajet e nevojshme për zonën e banimit, udhëzime dhe rregulla të detajuara për përdorimin e tokës, intensitetin e ndërtimit, karakteristikat arkitektonike dhe aspekte të tjera nevojshme për zhvillimin e planifikuar të zonave të banimit.

PZHK synon të përmbushë konceptin e menaxhimit të pronës në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë pronarët, pa dallim, përfshirë këtu zonat e reja të ndërtimit, zonat industriale dhe të gjelbra, dhe të gjitha aspektet e zhvillimit të infrastrukturës. Megjithatë, në analizën tonë, sfiduese është mungesa e specifikimeve të detajuara për këto zona, duke përfshirë ndikimin e tyre në korridoret e qarkullimit të

shtazëve dhe ekosistemet natyrore. Nëse janë marrë masa për të siguruar qarkullim natyror të shtazëve dhe mbrojtjen e llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, si dhe për të adresuar pyllëzimin, ripyllëzimin, dhe krijimin e hapësirave të gjelbra dhe të zonave rekreative.

Si konkludim, për përmbushjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara, është e nevojshme të zbatohen parime të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor, duke u mbështetur në konceptin e zhvillimit kompakt dhe të ndërlidhur, siç parashihet edhe në PZHK. Zhvillimi kompakt mundëson shfrytëzim më efikas të infrastrukturës ekzistuese, ul nevojën për zgjerim të pakontrolluar të zonave të ndërtimit dhe redukton presionin mbi resurset natyrore.

Në mënyrë të përmbledhur, objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadër të planit mund të përmbliken si më poshtë:

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe eliminimi i deponive ilegale;
- Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore nga ndotja;
- Përmirësimi i menaxhimit dhe trajtimit të ujërave të zeza;
- Ruajtja e tokave bujqësore me bonitet të lartë dhe parandalimi i degradimit të tyre;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i emetimeve nga ngrohja individuale dhe trafiku;
- Rritja e efikasitetit energjetik dhe promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë;
- Ruajtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra, korridoreve ekologjike dhe habitateve natyrore;
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve të lidhura me rrjedhat ujore dhe sipërfaqet pyjore;
- Mbrojtja nga vërshimet dhe reduktimi i proceseve erozive;
- Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe peizazhore;
- Përmirësimi i monitorimit të parametrave mjedisor, veçanërisht për cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës;
- Integrimi i kriterëve mjedisorë në zhvillimet e ardhshme urbane, ekonomike dhe infrastrukturore me qëllim sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

PIKAT E FORTA TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT

Në qendër të strategjisë është koncepti i zhvillimit kompakt dhe të ndërlidhur, i cili merr parasysh balancimin ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës. Strategjia bazohet mbi potencialet ekzistuese të komunës si resurset bujqësore, pozitën gjeografike, identitetin rural dhe kapacitetet zhvillimore. Plani përcakton strategji të qarta dhe të lidhura me plane konkrete veprimi për të siguruar zbatim të qëndrueshëm të planit. Gjithashtu inkurajon një përfshirje të gjerë të palëve të interesuara dhe përdor proces të hapur dhe të përfshirë gjatë konsultimeve publike, ku identifikon sfidat që ndeshet komuniteti dhe metodat për t'u përgjigjur këtyre sfidave si dhe mbështet dhe strukturon dialogun ndërmjet palëve dhe ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve të bazuara në konsensus.

Strategjia e planifikimit do të shërbejë si mjet për menaxhimin e ndryshimeve që ndihmon në përcaktimin e përparësive dhe përmirëson përgjigjen institucionale dhe atë vendimmarrëse.

Sa i përket nevojës për rritjen/zgjerimin e shërbimeve plani:

- Ndihmon për të identifikuar kërkesën për shërbim dhe burime;
- Integron aspektet sociale, mjedisore, ekonomike, institucionale dhe kulturore;
- Njeh pasuri të prekshme dhe të paprekshme kulturore që i shtojnë vlerën e cilësisë së jetës;
- Ndërton mundësi për tendencat e reja dhe potencialin krijues;
- Vendos çështjet mjedisore si prioritet i zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit;
- Shërben si platformë për zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të bujqësisë, zhvillimit rural, energjisë së rinovueshme dhe menaxhimit të territorit
- Ofron instrumente fleksibile që autoritetet t'i përgjigjen shpejtë fatkeqësive të mundshme natyrore.

7.4. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT, CILËSIA, OFRIMI I SHËRBIMEVE, DHE EFIÇENCA E ENERGJISË

Strategjitë e zhvillimit të komunave në të shkuarën, kishin prirje t'i trajtonin çështjet e mjedisit si 'shtojca' të strategjive, pa u kushtuar vëmendjen që këto kanë sot. Ky vlerësim strategjik mjedisor vlerëson tendencën e strategjisë së planit për të marrë parasysh ndikimet e prodhimit urban dhe konsumit përtej kufinjve të zonës urbane, minimizimin e ndikimit mbi sipërfaqet e gjelbra, tokën pjellore, lumenjtë, biodiversitetin, ndryshimin e klimës, etj. Është e rëndësishme që plani të marrë në konsideratë çështje dhe formulojë strategji specifiku në tri fusha për të përmirësuar performancën mjedisore:

- Cilësia e mjedisit
- Cilësia e ofrimit të shërbimeve
- Efiçenca e energjisë

Lidhur me këto tri fusha, me theks të veçantë cilësia e mjedisit, përcaktohen kritere të cilat duhen respektuar me qëllim ruajtjen e mjedisit të komunës.

KRITERET E FORTA MJEDISORE

Këto kritere përcaktojnë hapësirat dhe resurset që kërkojnë mbrojtje të veçantë gjatë zhvillimit të territorit.

(I) Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore përfshijnë:

- Burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Tokat bujqësore me bonitet të lartë;
- Sipërfaqet pyjore dhe zonat me vegjetacion natyror;
- Korridoret ekologjike përgjatë rrjedhave ujore.

Në këto zona, zhvillimet duhet të planifikohen në mënyrë që të shmangen ndikimet që mund të shkaktojnë degradimin e tyre.

(II) Zonat me kufizime për zhvillim përfshijnë:

- Shtretërit e lumenjve dhe zonat mbrojtëse përgjatë tyre;
- Hapësirat e ekspozuara ndaj vërshimeve;
- Zonat me ndjeshmëri ndaj proceseve erozive;
- Tokat bujqësore me vlerë të lartë prodhuese.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve (qoftë dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erozion të brigjeve, si dhe të cenojnë regjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Tokat bujqësore janë të rëndësishme për prodhimin bujqësor dhe si të tilla, ndërhyrjet e paplanifikuara dhe praktikatat bujqësore jo-të qëndrueshme rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të rënda të burimeve ujore nëntokësore dhe degradimin e tokës.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat vulnerabël ndaj proceseve të erozionit dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Plani përmban “hartën e planifikuar për mbrojtjen nga rreziqet natyrore”.

(III) Zonat me presione mjedisore ekzistuese

Në territorin e Komunës së Mamushës nuk identifikohen lokalitete industriale apo zona të degraduara në shkallë të gjerë që klasifikohen si “hot-spot” mjedisor. Megjithatë, deponitë ilegale të evidentuara në territorin komunal, zonat e ekspozuara ndaj deponimit të pakontrolluar të mbeturinave dhe segmentet e rrjedhave ujore të ndikuara nga shkarkimet e ujërave të zeza, paraqesin hapësira që kërkojnë monitorim dhe masa rehabilituese.

8. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

8.1. METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SHKALLËS SË NDIKIMEVE

Për parashikimin e karakteristikave të shkallës së ndikimeve, janë përdorur metoda të ndryshme, duke përfshirë vëzhgimet e thjeshta, ilustrime fizike, informacione sasiore, etj. Identifikimi i ndikimeve mjedisore është zhvilluar përmes metodave që përfshijnë listat e kontrollit, matricat, rrjetet dhe diagrama, GIS dhe gjykime profesionale.

Para përshkrimit të ndikimeve në mjedis, janë analizuar të gjitha zhvillimet e planifikuara sipas planit. Gjatë hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Mamushës, me theks të veçantë janë përfshirë këta komponentë mjedisorë:

Identifikimi i efekteve/ndryshimeve për elementet e mëposhtme:		
Uji	Sipërfaqësor	Shkarkime të substancave toksike, inorganike, organike, etj
	Nëntokësor	Filtrime drejt ujërave nëntokësorë
Ajri		Emetimet në ajër që ndikojnë në cilësinë e ajrit
Klima		Emetimet e gazrave me efekt serrë
Toka		Erozioni dhe sedimentimi
Zhurmat		Emetimet e mundshme të zhurmës
Flora, fauna, habitat		Ndikimet e zhvillimeve të propozuara mbi florën, faunën dhe ç'rregullimin e habitateve
Peizazhi		Ndryshime thelbësore të formës së përdorimit të tokës p.sh. shpyllëzim, urbanizim, etj.
Mbeturinat		Depozitimi, djegia dhe riciklimi
Vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore		Asete të cilat mund të dëmtohen nga aktivitetet e propozuara

Tabela 3 Komponentët mjedisor të parapara në raportin e VSM

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të Planit Zhvillimor Komunal për Mamushën është realizuar në përputhje me qasjet e rekomanduara ndërkombëtarisht për vlerësimin strategjik mjedisor. Për të arritur këtë, është përdorur një metodologji që synon të identifikojë, analizojë, dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore të zhvillimeve të propozuara në plan.

8.2. PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Indikatorët mjedisorë janë përcaktuar për të vlerësuar ndikimet e ndryshme të zhvillimeve të planifikuara në tokë, ujë, ajër, biodiversitet, klimë, mbeturina, zhurmë, peizazh, dhe trashëgimi kulturore. Për secilin indikatorë, janë përdorur kriteret e vlerësimit si mëposhtë:

A

Pa ndikim/ndikim pozitiv:

Zhvillimet e planifikuara nuk kanë ndikim negativ ose kontribuojnë pozitivisht ndaj qëllimeve mjedisore.

B

Ndikim i parëndësishëm:

Ndikimet janë të vogla dhe nuk pritet të kenë efekte të ndjeshme afatgjate.

C

Ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse:

Ndikimet potencialisht negative mund të zbuten efektivisht përmes zbatimit të masave të përshtatshme.

D

Ndikim i rëndësishëm:

Ndikimet janë të mëdha dhe mund të kenë efekte të konsiderueshme negative mjedisore që kërkojnë veprime të mëtejshme për menaxhimin e tyre.

E

Ndikim shkatërrues:

Ndikimet janë aq të mëdha sa që mund të dëmtojnë seriozisht mjedisin ose të çenojnë qëndrueshmërinë e zonave të caktuara.

X

Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur:

Nuk ka mjaftueshëm të dhëna për të bërë një vlerësim të qartë ose ndikimi është shumë kompleks për të vlerësuar në këtë fazë.

Indikatori	Zhvillimi i planifikuar	Përshkrimi i ndikimit	Shkalla e vlerësimit	Masa zbutëse
Uji	Menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave dhe përmirësimi i infrastrukturës ujore	Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit do të përmirësojë cilësinë e ujit dhe menaxhimin e ujërave të ndotura	A	Zbatimi i projekteve të kanalizimit, monitorimi i cilësisë së ujit dhe mbrojtja e burimeve ujore
	Korridori i zhvillimit ekonomik	Potencial për rritje të presionit mbi burimet ujore	C	Kontrolli i shkarkimeve dhe respektimi i standardeve mjedisore gjatë zhvillimit të aktiviteteve ekonomike
Ajri	Zhvillimi ekonomik, transporti dhe aktivitetet ndërtimore (densifikimi i qendrës urbane)	Rritje e përkohshme e emetimeve të pluhurit dhe gazrave gjatë ndërtimit dhe operimit të aktiviteteve të reja	B/C	Kontrolli i pluhurit, gjelbërimi dhe promovimi i efikasitetit energjetik
Klima	Promovimi i energjisë së rinovueshme	Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë dhe rritje e qëndrueshmërisë klimatike	A	Mbështetja e teknologjive të energjisë së pastër dhe efikasitetit energjetik
Toka	Mbrojtja e tokës bujqësore	Ruajtja e tokave me bonitet të lartë dhe kufizimi i shndërrimit të tyre në përdorime të tjera	A	Zbatimi i kufizimeve për zhvillim në tokat bujqësore me vlerë të lartë
	Densifikimi i qendrës urbane	Presion minimal për zgjerim të pakontrolluar në tokat bujqësore	A/B	Orientimi i zhvillimit brenda zonave ekzistuese të ndërtimit
Flora, fauna, habitati	Krijimi i korridoreve ekologjike	Përmirësim i lidhshmërisë ekologjike dhe mbrojtje e biodiversitetit lokal	A	Ruajtja e vegjetacionit ekzistues dhe rehabilitimi i habitateve të degraduara
	Zhvillimi i agro-turizmit dhe turizmit rural	Ndikime të kufizuara në habitatet natyrore në rast të menaxhimit jo të duhur të zhvillimit	B/C	Kufizimi i ndërhyrjeve në zona të ndjeshme dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme
Peizazhi	Zhvillimi kompakt dhe i ndërlidhur	Përmirësim i organizimit hapësinor dhe ruajtje e karakterit rural të territorit	A/B	Integrimi i hapësirave të gjelbra dhe ruajtja e elementeve karakteristike të peizazhit
	Korridori zhvillimor ekonomik	Ndryshim i pjesëshëm i karakterit vizual të territorit	C	Projektim i harmonizuar me karakterin rural dhe peizazhin ekzistues

Mbeturinat	Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave	Përmirësim i sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe reduktim i deponimit të pakontrolluar	A	Zgjerimi i mbulimit me shërbim dhe promovimi i riciklimit
Zhumat	Zhvillimet infrastrukturore dhe ekonomike	Rritje e përkohshme e niveleve të zhurmës gjatë ndërtimit dhe operimit	B/C	Kufizimi i aktiviteteve me zhurmë të lartë dhe përdorimi i brezave mbrojtës të gjelbër
Trashëgimia kulturore	Zhvillimi i turizmit rural dhe përmirësimi i hapësirave publike	Mundësi promovimi të trashëgimisë kulturore lokale	A/B	Respektimi i zonave mbrojtëse dhe integrimi i trashëgimisë në zhvillimet e reja
Rreziqet natyrore	Zona tampon përgjatë lumit Toplluha dhe masa mbrojtëse ndaj vërshimeve	Ulje e ekspozimit ndaj vërshimeve; mbrojtja e tokës bujqësore dhe infrastrukturës	A	Zbatimi i masave për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjen nga vërshimet

Tabela 4 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisore

Tabela 4 përdor indikatorë dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuar për të përshkruar se aspekti i zhvillimeve të propozuara mund të ndikojë në mjedisin, dhe si mund të menaxhohen këto ndikime përmes zbatimit të masave të përshtatshme zbutëse.

Sipas këtyre rezultateve, shihet që ndikimet pozitive mbizotërojnë në shumicën e komponentëve mjedisorë. Ndikimet më pozitive janë në komponentët e ujit, tokës bujqësore, mbeturinave, biodiversitetit, trashëgimisë kulturore dhe reduktimin e rrezikut nga vërshimet. Megjithatë, ka edhe ndikime potencialisht negative në komponentën e ajrit, zhurmave dhe peizazhit. Ndikimet vlerësohen të menaxhueshme përmes strategjive të mitigimit dhe zbutjes.

Niveli i përputhshmërisë mjedisore të Objektivave të Planit në funksion të Objektivave Mjedisore (OM)

Fushat tematike	Objektivat mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	OM10	
	Qëllimet e PZHK	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Nd. Klimatike	T. Natyrore dhe Kulturore	Shëndeti	Social-ekonomik	
ZHVILLIMI EKONOMIK	Q1	+/-	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	0	+	++	
	Q2	+	+	+	+	+	++	+	++	+	++	
	Q3	++	++	++	+	0	0	++	0	++	++	
	Q4	+/-	+/-	+	+/-	0	+	+/-	0	+	++	
INFRASTRUKTURA TEKNIKE	Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit											
	Q1	+	++	+	+	0	0	+	0	++	++	
	Q2	+	++	+	++	0	0	+	0	++	++	
	Energjia elektrike											
	Q1	++	+	+	+	+	0	++	0	++	++	
	Energjia termike											
	Q1	+	0	0	0	0	0	+	0	+	+	
	Telekomunikimi dhe instalimet e ngjashme											
	Q1	0	0	0	0	0	0	+	0	+	++	
	Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave											
Q1	+	++	++	+	0	++	+	+	++	++		
INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT	Q1	+/-	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	0	+	++	
	Q2	0	0	0	0	0	0	0	0	++	++	
	Q3	+	0	0	0	0	+	++	0	++	++	
	Q4	+	0	0	0	0	0	+	0	+	++	
	Q5	0	0	+/-	0	0	+/-	0	0	+	+	
MJEDISI DHE SIP. ME RREZIKSHMËRI	Q1	+	++	+	+	0	+	+	0	++	+	
	Q2	++	0	0	0	0	0	++	0	++	+	
	Q3	0	+	++	+	0	+	+	0	+	+	
	Q4	+	+	+	++	++	+	+	+	+	+	
	Q5	+	+	+	+	0	+	++	0	++	+	
T. KULTURORE DHE NATYRORE	Q1	+	+	+	+	+	++	0	++	+	++	
VENDBANIMET	Q1	+	+	+	0	0	+	0	+	++	++	
	Q2	+	+	0	0	0	+	0	0	++	++	
	Q3	0	+	+	0	0	+	0	0	+	++	
	Q4	+	+	++	+	0	+	0	0	+	++	
	Q5	+	+	0	0	0	+	0	0	++	++	
	Q6	0	0	+	0	0	0	0	0	+	++	
	Q7	0	0	0	0	0	0	0	0	+	++	
V. JOFORMALE	Q1	+	+	+	0	0	+	0	0	++	++	
	Q2	+	+	0	0	0	+	0	0	++	++	
	Q3	0	+	+	0	0	+	0	0	+	++	
	Q4	+	++	+	0	0	++	+	0	++	++	
SHFRYTËZIMI I TOKËS	Q1	+	+	++	+	0	+	+	0	+	++	
	Q2	+	+	++	+	0	+	+	0	+	++	
	Q3	+	0	+	0	0	+	0	0	++	++	
	Q4	+/-	+/-	+	+/-	+	+	+/-	0	+	++	

Tabela 5 Tabela e përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit në funksion të OM

Sqarim:

++	Përputhshmëri në nivel të konsiderueshëm;
+	Përputhshmëri e knaqshme;
0	Nuk ka efekt;
-	Konflikt i vogël i mundshëm;
- / -	Konflikt i mundshëm domethënës;
+/-	Elemente të puthshmërisë dhe konfliktit;

Objektivat e planit përpiqen të arrijnë një balancë midis zhvillimit dhe mbrojtjes së mjedisit, por kjo vjen me sfida të ndryshme në përputhshmëri dhe konflikte. Analiza e përputhshmërisë mes objektivave të PZHK-së dhe objektivave mjedisore tregon se një pjesë e madhe e ndërhyrjeve të planifikuara, paraqesin përputhshmëri pozitive me komponentët mjedisor.

Vlerësimi identifikon gjithashtu se disa objektiva të lidhura me zhvillimin ekonomik, zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe zhvillimin e infrastrukturës së transportit mund të gjenerojnë presione të caktuara mbi resurset natyrore, veçanërisht në aspektin e përdorimit të tokës, burimeve ujore, biodiversitetit dhe peizazhit. Megjithatë, këto ndikime nuk vlerësohen si kufizuese për zbatimin e planit, pasi mund të menaxhohen dhe zbuten me zbatimin e masave mbrojtëse, instrumenteve të planifikimit hapësinor dhe monitorimit të vazhdueshëm mjedisor.

Në përgjithësi, rezultatet e vlerësimit tregojnë se PZHK-ja e Komunës së Mamushës është në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, duke krijuar një kornizë zhvillimore që synon balancimin e nevojave ekonomike dhe sociale me ruajtjen e resurseve natyrore, vlerave peizazhore, biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore e kulturore.

Efektet kumulative

Efektet kumulative i referohen ndikimeve të kombinuara të planit në mjedis me kalimin e kohës, duke marrë parasysh ndërveprimet e tyre dhe çdo sinergji ose kompromis. Në kontekstin e VSM-së, është e rëndësishme të merren parasysh efektet kumulative sepse projektet individuale mund të kenë ndikime minimale në vetvete, por kur kombinohen me projekte ose aktivitete të tjera, efektet kumulative mund të jenë të rëndësishme. Kjo mund të rezultojë në degradimin e mjedisit dhe përkeqësimin e cilësisë së jetës për komunitetin.

Për qëllime vlerësimi të mëtejme, do të konsiderohen prioritetet strategjike të planit, të cilat potencialisht mund të kenë ndikim në mjedis.

Për vlerësimin e efekteve kumulative janë përdorur kriteret e mëposhtme:

- A - Ndikim pozitiv me objektivat mjedisore;
- B - Ndikim i vogël pozitiv ose neutral;
- C - Ndikim i moderuar;
- D – Ndikim i rëndësishëm negativ;
- E - Ndikim potencialisht kritik;
- X – Vlerësimi nuk është i mundur.

Elementet që vlerësohen	Zhvillimi ekonomik dhe korridori zhvillimor	Agro-turizmi dhe aktivitetet rurale	Menaxhimi i ujërave	Menaxhimi i mbeturinave	Infrastruktura e transportit	Mbrojtja e biodiversitetit dhe habitateve	Mbrojtja e tokës bujqësore	Trashëgimia kulturore dhe natyrore
Uji	C	B	A	A	C	A	A	A
Ajri	C	B	A	B	C	A	A	A
Klima	B	B	A	B	C	A	A	A
Toka	C	B	B	A	C	A	A	A
Zhurma	C	A	A	A	C	A	A	A
Flora/Fauna	C	B	A	B	C	A	A	A
Mbeturinat	B	B	A	A	B	A	A	A
Trashëgimia natyrore e kulturore	B	A	A	A	B	A	A	A

Tabela 6 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së

9. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

9.1. KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, ZHVILLIMI KOMPAKT

Analiza e gjendjes ekzistuese tregon se një nga sfidat kryesore të zhvillimit hapësinor në Komunën e Mamushës lidhet me ruajtjen e tokës bujqësore dhe orientimin e zhvillimit në përputhje me kapacitetet territoriale dhe mjedisore të komunës. Duke qenë se territori i komunës dominohet nga toka bujqësore me vlerë të lartë prodhuese, është e nevojshme që zhvillimet e ardhshme të orientohen drejt përdorimit racional të tokës dhe kufizimit të zgjerimit të panevojshëm të zonave ndërtimore. Koncepti i zhvillimit kompakt dhe të ndërlidhur, i përzgjedhur, synon zhvillimin brenda strukturës ekzistuese të vendbanimit, duke shfrytëzuar infrastrukturën dhe hapësirat e disponueshme, si dhe duke reduktuar presionin mbi tokat bujqësore dhe resurset natyrore.

PZHK parashikon ruajtjen e sipërfaqeve bujqësore me bonitet të lartë, mbrojtjen e korridoreve ekologjike dhe zhvillimin e hapësirave të gjelbra si elemente të rëndësishme për ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe peizazhit rural. Gjithashtu, promovon masa për densifikimin e kontrolluar të zonave ekzistuese të banimit, duke shmangur zhvillimin e shpërndarë dhe fragmentimin e mëtejshëm të territorit.

9.2. NDRYSHIMET NË KLIMË

Masat e përfshira në VSM për adresimin e sfidave që lidhen me ndryshimin e klimës dhe ndotjen e ajrit, uljen e pasigurive në këto çështje, përfshijnë masa drejt përmirësimit të informacionit (shkencor, ekonomik dhe social), parashikimin e veçorive të ndryshme të atmosferës dhe ekosistemeve të prekura si dhe ndikimet shëndetësore dhe ndërveprimet e tyre me faktorët socio-ekonomikë.

Shqetësimi për ndryshimin e klimës, ndotjen e ajrit, ka sjellë kërkesa për informacion shkencor, ekonomik dhe social për të reduktuar pasiguritë në këto fusha. Qeverisja lokale, në bashkëpunim me organe përkatëse, organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare apo edhe sektori privat, duhen nxitur hulumtimin në proceset natyrore që ndikojnë dhe ndikohen nga atmosfera, duke studiuar lidhjet midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve të atmosferës. Bashkëpunimet janë të nevojshme për të zhvilluar sistemet e zbulimit të hershëm të ndryshimeve dhe eventeve potenciale, dhe parashikimin e ndryshimeve për vlerësimin e dëmeve mjedisore, sociale dhe ekonomike që ato mund të shkaktojnë.

Janë të nevojshme hulumtimet në zhvillimin e metodologjive për identifikimin e niveleve të pragut të ndotësve atmosferikë dhe përqendrimet e gazrave serrë, të cilat do të trajtohen tek seksioni i cilësisë së ajrit.

9.3. CILËSIA E AJRIT

Në Planin Zhvillimor Komunal, cilësia e ajrit trajtohet me analizë gjithëpërfshirëse me synimin të identifikojë burimet kryesore të ndotjes, vlerësim të tendencave aktuale dhe historike të ndotjes së ajrit, me bazë në të dhëna nga stacionet më të afërta monitoruese.

Një nga kufizimet kryesore për vlerësimin e gjendjes reale të cilësisë së ajrit mbetet mungesa e monitorimit lokal të parametrave kryesorë të ndotjes atmosferike, për të cilën arsye, rekomandohet krijimi i një sistemi monitorimi në nivel lokal, me qëllim sigurimin e të dhënave të besueshme për identifikimin e burimeve të ndotjes dhe vlerësimin e tendencave afatgjata të cilësisë së ajrit. Rrjedhimisht, të dhënat e monitorimit mundësojnë planifikimin dhe zbatimin më efektiv të masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së ajrit, rekomandohet promovimi i masave për rritjen e efikasitetit energjetik, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, reduktimin e djegies së mbetjeve në ambient të hapur dhe zëvendësimin gradual të sistemeve individuale të ngrohjes me alternativa më të pastra dhe më efikase.

Ngritja e hapësirave të gjelbra në shkallë qyteti (parqet, drunjtë në rrugë, etj.) dhe lagjeje (parqet e vogla, kopshtet e komunitetit, lulishtet, etj.), gjithashtu është një qasje tjetër e nevojshme, për nga përfitimet që sjellin, ekonomike, mjedisore dhe sociale.

9.4. PËRFITIMET NGA HAPËSIRAT E GJELBRA URBANE

Përfitime ekonomike:

Rritje e vlerës së pronës dhe truallit, ulje e kostos së energjisë (ngrohje-ventilim);

Përfitime mjedisore:

Përmirësim i cilësisë së ajrit, reduktimi i rrjedhës sipërfaqësore të reshjeve, erozionit të tokës, përmirësimi i cilësisë së ujit, mbrojtja dhe krijimi i habitateve për botën e gjallë, krijimi i buffer zonave (zonave mbrojtëse), reduktim i niveleve të zhurmës, absorbimi i ndotësve të ajrit, rritja e biodiversitetit urban siguron habitat, ushqim dhe mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve, etj.;

Përfitime sociale:

Përmirësojnë shëndetin fizik dhe mendor; rritje e mundësive për rekreacion; mundësi për aktivitet fizik, çiklizëm, vrapim, shëtitje, etj., zbutja e sëmundjeve respiratore, ndikojnë në rritjen e ndjenjës së pronësisë, stabiliteti i lagjeve, reduktimi i niveleve të zhurmës dhe krijimi i buffer zonave, edukim i hershëm për gjeneratat e reja, etj.

9.5. ENERGJIA E RINOVUESHME

Në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit racional të resurseve, PZHK i Komunës së Mamushës promovon integrimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme, veçanërisht energjisë solare. Duke njohur potencialin e konsiderueshëm për prodhimin e energjisë diellore, plani mbështet instalimin e sistemeve solare në objekte publike, biznese dhe ekonomi familjare, si një nga masat për reduktimin e konsumit të energjisë dhe emetimeve në mjedis. Paralelisht, rekomandohet mbështetje teknike dhe ekonomike për ekonomitë familjare për të kryer renovime që përfshijnë izolimin termik të objekteve, me qëllim efikasitetin energjetik dhe zvogëlimin e konsumit të energjisë. Ofrimi i stimujve, si subvencionimet dhe uljet e taksës për përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe instalimin e pajisjeve me efikasitet të lartë, si panelet solare, është gjithashtu një pjesë kyçe e tranzicionit energjetik. Këto stimuj do të nxisin komunitetin lokal dhe bizneset të investojnë në teknologji të gjelbërta, duke kontribuar në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

9.6. MBROJTJA E TOKËS

Mbrojtja e tokës në Planin Zhvillimor të Komunës është trajtuar si një çështje kryesore, duke pasë parasysh rëndësinë e tokave bujqësore për ekonominë lokale dhe sigurinë ushqimore. Çështjet kryesore lidhen me deponimin e pakontrolluar të mbeturinave, përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi,

proceset erozive dhe mungesën e të dhënave të vazhdueshme për cilësinë e tokës. Për problemet që lidhen me tokën propozohen masat e mëposhtme:

- Eliminimi dhe rehabilitimi/rikultivimi i lokacioneve të prekura nga deponimi ilegal i mbeturinave, me prioritet hapësirat pranë rrjedhave ujore dhe tokave bujqësore;
- Kufizimi i zgjerimit të zhvillimit ndërtimor në tokat bujqësore me bonitet të lartë dhe orientimi i zhvillimeve të reja në përputhje me kategoritë e planifikuara të shfrytëzimit të tokës;
- Kontrolli i përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në zonat me intensitet të lartë të prodhimit bujqësor;
- Zbatimi i masave për stabilizimin e tokës dhe reduktimin e proceseve erozive në zonat e identifikuar me ndjeshmëri ndaj erozionit dhe përgjatë brigjeve të lumit Toplluha;
- Krijimi dhe ruajtja e brezave mbrojtës me vegjetacion përgjatë rrjedhave ujore, me ndjeshmëri të lartë mjedisore;
- Integrimi i masave për mbrojtjen e tokës në projektet infrastrukturore dhe zhvillimore të planifikuara në territorin e komunës.

Sa i përket nevojës për monitorimin e cilësisë së tokës dhe vlerësimit të shkallës së erozionit, duhet të mirren masa për:

- Përcaktimin e stacioneve të monitorimit në zona kyçe, marrjen e mostrave dhe vlerësimin e cilësisë së tokës në mënyrë të vazhdueshme;
- Kryerja e analizave laboratorike për identifikimin e ndotësve potencialë dhe vlerësimin e gjendjes së tokës;
- Hartëzimi dhe monitorimi i zonave të ekspozuara ndaj erozionit dhe degradimit të tokës;
- Krijimi i një baze të të dhënave për monitorimin afatgjatë të cilësisë së tokës dhe proceseve të degradimit në territorin e komunës.

9.7. MBROJTJA E RESURSEVE UJORE

Ndotja e ujit është trajtuar sipas një analize të përgjithshme të problemeve dhe sfidave të cilësisë së ujit në lumenjtë e Komunës. Janë identifikuar burimet kryesore të ndotjes përfshirë këtu shkarkimin e ujërave të zeza pa trajtim, ndikimet nga aktivitetet bujqësore dhe mungesën e monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së ujit.

Për të siguruar menaxhim më efektiv të resurseve ujore dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna, VSM identifikon disa masa të cilat adresojnë shqetësimet aktuale të sektorit. Duke pasqyruar mungesën e të dhënave të vazhdueshme për gjendjen e ujërave, rekomandohet vendosja e stacioneve monitoruese në lumin Toplluha dhe në burimet kryesore ujore të shfrytëzuara për furnizim me ujë dhe për aktivitete

bujqësore. Një masë e tillë mundëson matjen e parametrave ndotës dhe sigurimin e të dhënave periodike për analizë dhe raportim të rregullt, si dhe identifikimin e hershëm të presioneve mjedisore.

Paralelisht me monitorimin, prioritet duhet t'i jepet investimeve në infrastrukturën e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, si masat më efektive për reduktimin e presioneve aktuale mbi trupat ujqorë. Rekomandohet fuqimisht promovimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe menaxhimi i kontrolluar i inputeve agro-kimike, me qëllim reduktimin e rrezikut të ndotjes difuze të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, veçanërisht në zonat e identifikuara me ndjeshmëri të lartë.

Në kuadër të mbrojtjes së resurseve ujore dhe reduktimit të rrezikut nga vërshimet, duhen paraparë projekte për rregullimin dhe rehabilitimin e shtratit të lumit Toplluha. Përveç masave konvencionale inxhinierike, ndërhyrjet duhet të synojnë ruajtjen dhe përmirësimin e funksioneve natyrore të korridorit lumor, përmes ruajtjes së vegjetacionit përgjatë brigjeve, krijimit të brezave mbrojtës dhe kufizimit të aktiviteteve që cenojnë stabilitetin e ekosistemit lumor.

9.8. REDUKTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE

Në kuadër të mbrojtjes dhe minimizimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ruajtjes së mjedisit, janë identifikuar masa specifike:

- Hartëzimi i zonave të ekspozuara ndaj vërshimeve, erozionit dhe rreziqeve të tjera;
- Përgatitja dhe përditësimi periodik i planeve lokale të reagimit ndaj emergjencave, përfshirë mekanizmat e paralajmërimit të hershëm;
- Masa inxhinierike dhe bio-inxhinierike për stabilizimin e sipërfaqeve të ndjeshme ndaj degradimit;
- Zbatimi i ndërhyrjeve mbrojtëse në segmentet e identifikuara me rrezik nga rrëshqitjet ose paqëndrueshmëria e terrenit;
- Mirëmbajtja periodike e rrjedhave ujore dhe largimi i pengesave që mund të kufizojnë rrjedhjen normale të ujit gjatë periudhave me reshje intensive;
- Ruajtja dhe shtimi i mbulesës bimore në zonat e ndjeshme, për rritjen e stabilitetit të terrenit dhe zvogëlimin e ndikimeve nga proceset erozive;
- Integrimi i kritereve të rrezikshmërisë natyrore në planifikimin e zhvillimeve të reja.

9.9. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Në Planin Zhvillimor Komunal, fusha e menaxhimit të mbetjeve trajtohet si një çështje komplekse dhe sfiduese që kërkon një sërë ndërhyrjesh për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese dhe për të adresuar mungesat në zbatimin e politikave dhe nismave për menaxhimin e mbetjeve.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Mamushës karakterizohet nga mbulueshmëri e kufizuar e shërbimit, mungesa e aktiviteteve të organizuara të riciklimit dhe prania e deponive ilegale në territorin e komunës. Si rrjedhojë, prioriteti kryesor duhet të jetë zgjerimi i mbulimit me shërbim, eliminimi i burimeve ekzistuese të ndotjes dhe krijimi gradual i elementeve të menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Masat e propozuara për adresimin e sfidave lidhur me menaxhimin e mbeturinave komunale:

- Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave; mbulim i plotë i territorit dhe përfshirjen e të gjitha kategorive të klientëve në sistemin formal të menaxhimit;
- Mbyllja, pastrimi dhe rehabilitimi i deponive ilegale të identifikuara në territorin e komunës, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i lokacioneve të ekspozuara;
- Krijimi i një sistemi të inventarizimit dhe monitorimit të gjenerimit, grumbullimit, transportimit dhe trajtimit të mbeturinave, si bazë për planifikim dhe vendimmarrje;
- Ngritja e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e ndarë të mbeturinave të riciklueshme, të rrezikshme dhe atyre organike; Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të programeve për grumbullimin e ndarë të mbeturinave;
- Ngritja e kapaciteteve për inspektim mjedisor;
- Promovimi i kompostimit të mbetjeve organike dhe integrimi gradual i parimeve të ekonomisë qarkore në sistemin lokal.

10. PLANI I MONITORIMIT

Monitorimi në vetvete, është grumbullimi sistematik, analiza dhe përdorimi i informacionit mbi progresin e një strategjie, plani, programi apo projekti, në një periudhë të caktuar. Ai jep mundësinë për konstatimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre gjatë zbatimit. Bazohet mbi objektivat e caktuara dhe aktivitetet e planifikuara gjatë fazave të planifikimit të procesit, duke ndihmuar në ruajtjen e përqendrimit në kapacitetet dhe kapacitete më të mira të menaxhimit. Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor mandaton autoritetet përgjegjëse të monitorojnë efektet e mundshme mjedisore të secilit plan apo program, me qëllim identifikimin e efekteve të kundërta, të paparashikuara, në një fazë më të hershme, që të mund të ndërmerren veprime të menjëhershme rehabilituese.

Deri më sot, Kosova ka ndjekur përafrimin me standardet mjedisore të BE-së me përparime të rëndësishme në legjislacion në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në tërësi, VNM, VSM, IPPC (International Plant Protection Convention) dhe Mbrojtjen e Natyrës. Mbrojtja e Mjedisit, VSM, VNM dhe Planifikimi Hapësinor grupohen në legjislacionin horizontal dhe transpozimi i legjislacionit të BE-së në sektorin horizontal është i avancuar. Direktiva e VSM 2001/42/EC dhe Direktiva për Pjesëmarrjen Publike 2003/35/EC raportohen si të transpozuar plotësisht. Për sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis, transpozimi i plotë është arritur në lidhje me dispozitat e Direktivës 2011/92/BE.

Neni 10 i Direktivës së VSM gjithashtu mandaton shtetet anëtare të monitorojnë efektet e rëndësishme mjedisore të zbatimit të planeve dhe programeve në mënyrë që, ndër të tjera, të identifikojnë në një fazë të hershme efektet negative të paparashikuara dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese.

Qëllimi i planit të monitorimit është që të sigurojë të dhëna përmes të cilave vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, duke siguruar që aktivitetet e propozuara nuk shkaktojnë nivele të papranueshme të efekteve mjedisore apo rrezik për shëndetin publik. Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve.

Me qëllim që PZHK të zbatohet me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë paraparë me këtë plan, është e domosdoshme që të monitorohet zbatimi i të njëjtit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis. Në mënyrë që zbatimi i planit të monitorimit mjedisor të jetë sa më efektiv, tabela e mëposhtme i referohet objektivave të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit dhe seksionin që trajton ndikimet dhe masat zbutëse. Realizimi me sukses kërkon angazhimin e institucioneve relevante, për bashkërendimin e aktiviteteve përkatëse monitoruese nën drejtimin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Komuna e Mamushës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së. Sipas Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, rezultatet e monitorimit duhet të publikohen nga Komuna, në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit dhe monitorimin, duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën e VSM, dhe rezultatet t'i përcillen Komunës dhe AMMK-së. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor t'i publikojë në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Receptorët mjedisor	Objektivat Mjedisore	Indikatori	Raportimi	Institucioni përgjegjes
Uji	Ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	Monitorimi i parametrave fiziko-kimikë të lumit Toplluha; monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore; numri i lidhjeve në rrjetin e kanalizimit; progresi në trajtimin e ujërave të ndotura	6 muaj	Komuna/DSHPM IHMK /AMMK KRU
Ajri	Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i emetimeve	Monitorimi i rregullt i parametrave të cilësisë së ajrit (PM2.5 PM10, NO2, SO2, CO) në komunë; numri i objekteve me masa të efijencës energjetike; sipërfaqet e gjelbëruara	Vjetor	Komuna AMMK/IHMK
Toka	Mbrojtja e tokës bujqësore dhe reduktimi i degradimit të saj	Sipërfaqja e tokës bujqësore e ruajtur; numri i deponive ilegale të rehabilituara; sipërfaqet e prekura nga erozioni; ndryshimet në përdorimin e tokës	Vjetor	Komuna/DB MBPZHR
Biodiversiteti	Ruajtja e biodiversitetit dhe habitateve natyrore	Sipërfaqja e brezave mbrojtës përgjatë Toplluhës; sipërfaqet e gjelbëruara; gjendja e habitateve natyrore dhe koridoreve ekologjike	Vjetor	Komuna AMMK
Peizazhi dhe ekosistemet	Ruajtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror, mbrojtja e sipërfaqeve pyjore, koridoreve ekologjike dhe funksioneve të ekosistemeve	Sipërfaqja e pyllëzuar; gjendja e koridoreve ekologjike; sipërfaqja e hapësirave të gjelbra; ndërhyrjet në peizazh; shkalla e degradimit të sipërfaqeve natyrore	Vjetor	Komuna AMMK MBPZHR
Klima dhe energjia	Rritja e efijencës energjetike dhe përdorimit të energjisë së rinovueshme	Emisionet e gazrave serrë; Sipërfaqja e objekteve (m2) me izolim adekuat; Sipërfaqja (m2) e paneleve solare të instaluar; progresi në zbatimin e objektivave energjetike	Vjetor	Komuna Ministria e Ekonomisë
Mbeturinat	Menaxhimi i integruar dhe reduktimi i ndotjes nga mbeturinat	Shkalla e mbulimit me shërbim; numri i deponive ilegale; sasia e mbeturinave të grumbulluara; sasia e mbetjeve të ricikluara	6 muaj	Komuna Operatori
Trashëgimia natyrore dhe kulturore	Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore	Statusi i aseteve të mbrojtura; numri i projekteve të restaurimit dhe promovimit	Vjetor	Komuna/DAKRS Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyres
Shëndeti	Përmirësimi i shëndetit publik dhe reduktimi i rreziqeve mjedisore	Treguesit e shëndetit publik të lidhur me faktorët mjedisorë; mbulueshmëria me shërbime bazë; ekspozimi ndaj rreziqeve natyrore	Vjetor	Komuna/DSHMS

Tabela 7 Plani i Monitorimit Mjedisor

11. PËRFUNDIME

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i PZHK së Komunës së Mamushës, ka për qëllim të integrojë sistematikisht çështjet mjedisore. Gjatë implementimit të PZHK si dhe procesit të vendimmarrjes, VSM synon të marrë masa plotësuese për projektet të cilat do të realizohen. VSM, si e tillë përkufizohet si:

- Një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara;
- Instrumenti i cili do të sigurojë udhëzime për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve dhe konsideratave mjedisore të PZHK-së;
- VSM do të jep udhëzime për përfshirjen e çështjeve mjedisore në projektet të cilat do të realizohen në të ardhmen;
- Raporti i VSM-së propozon rregullore institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve mjedisore të PZHK-së.

PZHK prezanton një profil, koncept të zhvillimit hapësinor, vizion, prioritete strategjike, e masa zbatimi. Koncepti zhvillimor i përzgjedhur mbështetet në modelin e zhvillimit kompakt dhe të ndërlidhur, duke synuar organizimin më racional të territorit dhe shfrytëzimin më efikas të infrastrukturës ekzistuese.

Plani orienton zhvillimin e ardhshëm brenda strukturës ekzistuese të vendbanimit, përmes densifikimit të kontrolluar dhe përdorimit më efikas të hapësirave të lira brenda kufijve ndërtimorë. Njëkohësisht, synohet kufizimi i zgjerimit të pakontrolluar në tokat bujqësore dhe ruajtja e sipërfaqeve me vlerë të lartë prodhuese, të cilat përbëjnë një nga resurset më të rëndësishme të komunës.

Qasja e propozuar mundëson përmirësimin e qasjes në shërbime publike, optimizimin e investimeve infrastrukturore dhe krijimin e kushteve për zhvillim më të balancuar ekonomik, social dhe mjedisor. Në të njëjtën kohë, plani promovon ruajtjen e korridoreve ekologjike, hapësirave të gjelbra dhe karakterit rural të territorit, duke kontribuar në mbrojtjen e resurseve natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve.

PZHK ka rol përmbajtësor edhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë së ndërtimeve. PZHK, bashkë me sygjerimet që dalin nga VSM, mundohen të ndikojnë pozitivisht në revitalizimin e ekosistemeve të degraduara, ripyllëzimin e zonave të zhveshura, pyllëzimin e disa zonave që vazhdimisht janë nën ndikimin e erozionit, etj. Pozitivisht do të ndikojë edhe në ruajtjen e zonave të pasura me ujëra nëntokësore, ekosistemeve të lumenjve nga degradimi dhe nga ndërtimet pranë brigje të lumenjve.

Gjatë përpilimit të raportit të VSM, janë hasur sfida, si mungesa e studimeve në fushën e mjedisit, informata, hulumtime dhe analiza profesionale. PZHK ka identifikuar dhe trajtuar elemente me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë tokat bujqësore me vlerë të lartë prodhuese, rrjedhat ujore, zonat me ndjeshmëri ndaj erozionit dhe vërshimeve, sipërfaqet pyjore dhe të gjelbëruara, korridoret ekologjike, deponitë ilegale dhe hapësirat me potencial për pyllëzim dhe ripyllëzim. Megjithatë për një pjesë të këtyre elementeve ekzistojnë të dhëna bazë dhe orientime planifikuese, vazhdon të ketë mungesë të

informacionit të detajuar lidhur me cilësinë e tokës, gjendjen e ujërave nëntokësore, biodiversitetin lokal dhe parametrat e tjerë mjedisorë që do të mundësonin vlerësime më të avancuara të ndikimeve.

VSM mbështet qasjet drejt dekarbonizimit dhe promovimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, në përputhje me objektivat e PZHK-së. PZHK nënvizon rëndësinë e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe reduktimit gradual të varësisë nga lëndët djegëse tradicionale. Theksi vihet në promovimin e energjisë diellore, rritjen e efijencës energjetike dhe hulumtimin e mundësive për zhvillimin e sistemeve më efikase të furnizimit me energji termike.

Zbatimi i masave për izolimin termik të objekteve, instalimin e sistemeve solare dhe përdorimin e teknologjive me ndikim të ulët mjedisor pritet të kontribuojë në reduktimin e konsumit të energjisë dhe emetimeve në mjedis. Në të njëjtën kohë, projektet e ardhshme energjetike duhet të harmonizohen me kriteret e mbrojtjes së tokës bujqësore, peizazhit dhe resurseve natyrore të komunës, me qëllim minimizimin e ndikimeve të mundshme mjedisore.

12. LITERATURA

- (UNECE), n. N. (1998, June 25). Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters. Aarhus, Denmark.
- AMMK. (2024, Shtator). Raport vjetor për gjendjen e mjedisit 2023. Prishtinë.
- AMMK. (2025). Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë 2023-2024. Prishtinë
- Kosovës, R. e. (2009, Prill 06). Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Prishtinë.
- Kosovës, R. e. (2010, Tetor 29). Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Prishtinë.
- Programme, U. N. (2009). Planning Sustainable Cities-Global Report on Human Settlements. London: Earthscan.
- Union, E. (2001, June 27). Directive 2001/42/EC on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment.
- Union, E. (2003, May 26). Directive 2003/35/EC for public participation.
- Union, E. (2011, December 13). Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment.